

MANUAL UDHËZUES

ROLI DHE VEPRIMTARIA E NJËSIVE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

NË KONFLIKT ME LIGJIN, PAS KRYERJES SË DËNIMIT OSE PAS LIRIMIT ME KUSHT



Tiranë, Dhjetor 2022

MANUAL UDHËZUES

**ROLI DHE VEPRIMTARIA E NJËSIVE PËR MBROJTJEN E TË
DREJTAVE TË FËMIJËVE NË KONFLIKT ME LIGJIN, PAS KRYERJES
SË DËNIMIT OSE PAS LIRIMIT ME KUSHT**

Tiranë, Dhjetor 2022

Hartimi i këtij manuali udhëzues realizohet në kuadër të nismës “Drejt një mjedisi të sigurt, stimulues dhe rehabilitues në burgje për fëmijët dhe të miturit në konflikt me ligjin në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni”, zbatuar me mbështetjen financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Të dhënat e shprehura në këtë manual udhëzues janë përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës ose institucioneve përgjegjëse të përfshira në konsultimin e këtij materiali.

Përgatiti:

Prof. Dr. Vasilika Hysi, Eksperte ligjore e nivelit të lartë

Redaktor letrar:

1. Znj. Anda Kruetani, Asistente Projektsh, KShH
2. Znj. Ardita Kolmarku, Juriste/Menaxhere Projektsh, KShH
3. Z. Nikolin Muçaj, Praktikant pranë KShH



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: © Komiteti Shqiptar I Helsinkit

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. Brigada e VIII-të, Pallati “Tekno Projekt” Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752;

Tel: 04 2233671; **Cel:** 0694075732;

E-mail: office@ahc.org.al;

Web site: www.ahc.org.al

PËRMBAJTJA

Fjalor.....	5
AKRONIME/SHKURTIME.....	6
Hyrje.....	7
1. Të miturit në konflikt me ligjin në Shqipëri.....	8
2. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur dhe risitë e tij.....	9
3. Parimet e drejtësisë penale për të mitur.....	11
3.1 Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi.....	11
3.2 E drejta për zhvillim harmonik të të miturit.....	11
3.3 Parimi i proporcionalitetit.....	12
3.4 Drejtësia miqësore për çdo fëmijë.....	12
3.5 Qasja në drejtësi.....	12
3.6 Qasja në shërbime cilësore dhe të përshtatura sipas nevojave të çdo fëmijë.....	13
4 Standardet e kujdesit për të miturin në konflikt me ligjin.....	14
5 Mekanizmat për mbrojtjen e fëmijeve në kontakt/konflikt me ligjin.....	15
5.1 Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.....	16
5.2 Ministri përgjegjës për Çështjet e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.....	16
5.3 Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.....	16
5.4 Avokati i Popullit.....	17
5.5 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.....	17
5.6. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.....	17
6 Institucionet e angazhuara në mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e fëmijëve.....	18
6.1 Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR).....	18
6.2 Policia.....	18
6.3 Prokuroria.....	19
6.4 Gjykata.....	20
6.5 Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP).....	20
6.6 Shërbimi i Provës.....	21
6.7 Bashkitë.....	21
6.8 Grupi teknik ndërsektorial (GTN).....	21
6.9 Strukturat e ofrimit të ndihmës juridike falas.....	22
6.10 Mbrojtësi i të miturit në konflikt me ligjin.....	22
6.11 Ndërmjetësuesit.....	23
7 Përgatitja për lirim, kujdesi, rehabilitimi dhe rishoqërimi.....	25
Hyrje.....	25
Roli i NJMF për përgatitjen e të miturit për rikthim pas kryerjes së dënimit.....	26
-Informimi mbi kohën e lirim.....	26

-Përgatitja për lirim.....	26
-Institucionet që përfshihen në përgatitjen për rikthimin pas kryerjes së dënimit.....	26
-Roli i institucioneve.....	27
Institucioni i ekzekutimit të vendimit penal (IEVP).....	27
Bashkëpunimi i NJMF me QPKMR.....	27
Bashkëpunimi i NJMF me institucionet në nivel vendor.....	30
Roli i Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijës për përgatitjen e të miturit para lirimit me kusht.....	32
-Informimi për datën e lirimit me kusht.....	33
8. MBËSHTETJA PAS LIRIMIT.....	35
8.1 Llojet e mbështetjes së të miturit	35
8.2 Programet e edukimit dhe të rehabilitimit për të miturit e grupeve të veçanta.....	38
8.3 Detyrat e njësisë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës pas lirimit të fëmijës.....	39
9. Mbikëqyrja pas kryerjes së dënimit dhe dënimit me kusht.....	40
10. Praktika të mira të trajtimit të të miturve në konflikt me ligjin.....	41
11. Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në rolin e përfaqësuesit procedural.....	43
12. Mbrojtja e të dhënave personale të fëmijëve në kontakt dhe në konflikt me ligjin.....	44
13. Trajnimi dhe specializimi i punonjësve të NJMF.....	45
-Rëndësia.....	45
-Kërkesat ligjore sipas KDPM.....	45
-Punonjës të trajnuar dhe specializuar në drejtësinë për të mitur.....	46
-Trajnimet e grupit shumëdisiplinor.....	47
-Burimet njerëzore dhe financiare.....	47
-Monitorimi i pavarur.....	47
Shtojca 1: Kuadri ligjor bazë.....	48

Fjalor

I mitur është çdo person nën moshën 18 vjeç. Ky term përdoret kryesisht në legjislacionin penal.

I mitur në konflikt me ligjin është i mituri që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale dhe ka kryer një veprë penale që parashikohet në Kodin Penal.

Interesi më i lartë i fëmijës, është e drejta e fëmijës për të pasur zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror, shoqëror dhe e drejta për të gëzuar një jetë familjare dhe shoqërore të përshtatshme për fëmijën.

Institucion i ekzekutimit të vendimeve penale është institucioni ku vendoset i mituri në konflikt me ligjin në pritje të dhënies së vendimit nga prokurori ose gjykata dhe/ose për të kryer dënimin me burgim.

Mosha e përgjegjësisë penale është mosha e përcaktuar nga ligji penal me arritjen e së cilës i mituri ka përgjegjësi penale.

Drejtësi miqësore për fëmijë i referohet sistemeve të drejtësisë, që garantojnë respektimin dhe implementimin efektiv të të drejtave të fëmijëve bazuar në disa parime dhe standarde të përcaktuara në të drejtat konventore.

Drejtësi penale për të mitur nënkupton tërësinë e procedurave që lidhen me veprat penale dhe që përfshijnë hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e dënimit dhe çdo masë tjetër që përfshin të miturin në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar të një veprë penale.

Programe të drejtësisë restauruese nënkupton çdo masë që lejon të miturit në konflikt me ligjin të kuptojnë përgjegjësinë, të korrigjojnë pasojat e veprës penale që kanë kryer, të kompesojnë dëmin dhe/ose të pajtohen me viktimën dhe personat e tjerë që janë prekur nga vepra penale, dhe së bashku me viktimën të zgjidhin pasojat e veprës. Këto masa zbatohen me ndihmën e një personi të tretë, të pavarur.

Ndërmjetësim është procesi i zgjidhjes jashtëgjyqësore dhe me dialog të një konflikti mes të miturit që ka kryer një veprë penale dhe viktimës, që kryhet nga një ndërmjetës me qëllim zgjidhjen e pasojave të veprës penale dhe përmirësimin e marrëdhënieve midis tyre.

Lirim me kusht është një nga alternativat e dënimit me burgim, për përfitimin e së cilit i mituri në konflikt me ligjin duhet të plotësojë kriteret dhe kushtet e parashikuara në nenin 129 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Vepra penale është çdo veprim ose mosveprim që parashikohet i dënueshëm nga Kodi Penal.

Krim është çdo veprim dhe mosveprim me rrezikshmëri të lartë shoqërore që cilësohet i tillë në Kodin Penal.

Kundërvajtje penale është çdo veprim ose mosveprim me rrezikshmëri të pakët shoqërore që cilësohet si i tillë në Kodin Penal.

Vlerësim individual i të miturit është procesi që ndërmerret nga ana e çdo organi të drejtësisë penale për të mitur, për të vlerësuar rrethanat individuale, shëndetësore, familjare, sociale dhe mjedisore të të miturit, sipas nenit 22 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Rishoqërizimi ose rehabilitimi i të miturit është inkurajimi dhe zhvillimi i ndjenjës së përgjegjësisë për të respektuar të drejtat e të tjerëve, për të nxitur dhe mundësuar zhvillimin e shëndetshëm fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror të të miturit dhe përgatitja që ai të rikthehet në shoqëri.

AKRONIME/SHKURTIME

KDPM.....	<i>Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur</i>
NjMF.....	<i>Njësia e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve</i>
ASHDMF.....	<i>Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës</i>
QPKMR.....	<i>Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve</i>
IEVP.....	<i>Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale</i>
GTN.....	<i>Grupi Teknik Ndërsektorial</i>

Hyrje

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur (KDPM), i miratuar në vitin 2017 dhe hyrë në fuqi në Janar të vitit 2018 përbën bazën e re ligjore për trajtimin e të miturve në kontakt ose në konflikt me ligjin, si dhe përcakton institucionet që përfshihen në trajtimin e tyre.

Duke qenë se KDPM për herë të parë parashikon rregulla specifike për trajtimin e të miturit në konflikt me ligjin, procedura të reja dhe një qasje shumëdisiplinore të trajtimit të të miturit, manuali i referohet KDPM, por edhe ligjeve të tjera që mundësojnë shërbimet dhe standardet ndërkombëtare për mbështetjen e të miturit në konflikt me ligjin pas lirimit.

Manuali është një udhëzues praktik, që i shërben punonjësve të Njësisë së Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijës (NJMF) në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga KDPM në fazën e përgatitjes për lirim të të miturit, në mbështetjen pas lirimit dhe mbikëqyrjen e të miturit pas kryerjes së dënimit dhe dënimit me kusht. Nga ana tjetër, duke qenë se punonjësit e NJMF kanë formim në shkencat sociale, njohin shërbimet në bashki dhe shërbimet për fëmijët në nevojë mbrojtjeje, ku përfshihen edhe të miturit në konflikt me ligjin, këto shërbime trajtohen vetëm në raport me detyrimet që burojnë nga KDPM në fazën e mbështetjes dhe mbikëqyrjes së të miturit në konflikt me ligjin, pra të miturit e grupmoshës 14-18 vjeç.

Manuali përmban disa njohuri të përgjithshme për sistemin e drejtësisë penale për të miturit e një fjalorth termash. Konventa për të drejtat e fëmijës përdor termin “fëmijë” për çdo person nën moshën 18 vjeç, ndërsa KDPM përdor termin “i mitur” në emërtimin dhe në përmbajtjen e tij. Termi “i mitur” nënkupton çdo person nën moshën 18 vjeç, pavarësisht gjinisë së tij. Pra, në përmbajtjen e këtij manuali udhëzues, fëmijë dhe i mitur kanë kuptim të njëjtë.

Menaxhimi i rastit të një fëmije në konflikt me ligjin nuk është gjithnjë i lehtë, por jo i pamundur. Sado të mira të jenë standardet e parashikuara në ligj për mbështetjen e të miturit për t'u rehabilituar dhe rishoqërizuar, ky proces mund të jetë i sukseshëm vetëm kur të gjithë institucionet dhe aktorët e tjerë që përfshihen përmbushin në kohë dhe me përpikmëri detyrimet e tyre, bashkërendojnë dhe koordinojnë çdo veprim të tyre. Manuali përmban disa praktika të mira dhe disa praktika ku janë hasur vështirësi në trajtimin e të miturit në konflikt me ligjin nga të cilat mund të nxirren mësim për të ilustruar faktin. Fëmijët viktimë të krimit dhe fëmijët dëshmitarë nuk trajtohen në manual.

Një falenderim i veçantë për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Holandës, Komitetin Holandez të Helsinkit, punonjësit e Njësisë së Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve dhe Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve për mbështetjen, opinionet dhe sugjerimet e ofruara gjatë procesit të konsultimit të këtij manuali.

1. Të miturit në konflikt me ligjin në Shqipëri

Në Shqipëri, të miturit në konflikt me ligjin përbëjnë një përqindje të vogël në raport me numrin e përgjithshëm të personave të proceduar penalisht, por numri i tyre ka pësuar rritje në disa vite. Sipas *INSTAT*, gjatë periudhës **2017-2021**, policia ka regjistruar **20 229** fëmijë nën moshën **18 vjeç** të përfshirë në kriminalitet, me një tendencë ndër vite që varion nga **60.5** për **10 000 banorë** në **106.4 persona** për **10 000 banorë**. Në krahasim me vitin **2015**, numri i të miturve të proceduar penalisht nga prokuroria ka ardhur në rënie, veçanërisht në periudhën **2019-2020**. Gjatë periudhës **2017-2021**, prokuroria ka regjistruar **3 504** të pandehur të mitur, ndërsa janë dënuar **1 229 të mitur**, shumica për krime (**93%**). Fakti që pjesa më e madhe e të miturve kryejnë krime kërkon vëmendje të shtuar për parandalimin e hershëm të përfshirjes së tyre në kryerjen e veprave penale.

Ulje e numrit të të miturve të dënuar vihet re pas miratimit të **KDPM** që parashikon trajtim më social të të miturit në konflikt me ligjin, duke synuar ta mbajë larg atë nga privimi i lirisë dhe dënimi me burgim. Kështu, të miturit e burgosur përbëjnë një përqindje të vogël në popullsinë e burgjeve dhe numri i tyre ka ardhur në ulje nga viti në vit. Nga hyrja në fuqi e Kodit, ky numër varion nga **19-23 të mitur** dhe ata janë vendosur në *Institutin e të Miturve Kavajë*. Gjatë vitit **2021**, **25 të mitur të dënuar janë vendosur në këtë institucion dhe 20 të mitur janë liruar**. Koha e qëndrimit të të miturit në institucion varion, por në përgjithësi ajo është e shkurtër. Pjesa më e madhe e të miturve janë dënuar për vjedhje dhe vjedhje me dhunë. Kjo kategori e të miturve ka nevojë për mbështetje në prag të liritimit si dhe pas liritimit. Mbështetja e tyre do të jetë e suksesshme nëse fillon shumë më shpejt nga dita e liritimit nga institucioni.

Ndaj një pjesë të të miturve në konflikt me ligjin, gjykatat kanë zbatuar një nga alternativat e dënimit me burgim të parashikuar nga Kodi, duke i vendosur ata nën mbikëqyrjen e shërbimit të provës. Zbatimi i dënimeve afatshkurtëra për të miturit nuk nënkupton se i mituri nuk ka nevojë për përgatitje për lirim, mbështetje dhe mbikëqyrje pas liritimit. Ky proces fillon që ditën e parë kur i mituri hyj në institucion.

Nga ana tjetër, numri i të rinjve të grupmoshës **18-29 vjeç** të përfshirë në kryerjen e veprave penale është i lartë dhe në rritje nga viti në vit. Kjo është një arsye më shumë për të vënë theksin te riintegrimi sa më i mirë i të miturve që janë përfshirë për herë të parë në krim dhe për të parandaluar ripërfshirjen e tyre. Studimet tregojnë se mbështetja dhe mbikëqyrja e të miturit për të paktën 6 muaj nga kryerja e dënimit ose liritimit me kusht është i dobishëm dhe ndikon në riintegrimin dhe në parandalimin e rifutjes së tij në rrugën e krimit.

2. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur dhe risitë e tij

KDPM parashikon rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin të miturin në konflikt me ligjin, të miturin viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.

I mitur në konflikt me ligjin është çdo person që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale deri nën moshën *18 vjeç*, ndaj të cilit ekziston një dyshim i arsyeshëm se ka kryer një veprë penale, është marrë si i pandehur dhe/ose është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale. Legjislacioni shqiptar parashikon dy nivele të moshës minimale për përgjegjësi penale: moshën *14 vjeç* për krimet dhe *16 vjeç* për kundravajtjet penale. Cilësimi i një veprë penale si krim ose kundërvajtje penale bëhet në Kodin Penal. Krimet janë vepra penale me rrezikshmëri më të lartë shoqërore sesa kundërvajtjet penale. Fëmijët e grupmoshës *14 - 18 vjeç* konsiderohen të mitur. *Me mbushjen e moshës 18 vjeç*, personi quhet i rritur. Megjithatë, personat e moshës *18-21 vjeç*, nëse kanë kryer një veprë penale kur kanë qënë të mitur, gjykohen nga seksioni për të mitur dhe rregullat e KDPM zbatohen edhe për ta.

KDPM rregullon procedurën e administrimit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin, për të miturit viktimë dhe/ose dëshmitarë të veprave penale, por nuk rregullon procedurat e trajtimit të të miturit që kryen vepra penale nën moshën e përgjegjësisë penale. Në rastet kur një i mitur nën moshën e përgjegjësisë penale ka kryer një veprë penale, ndaj tij nuk fillon procedimi penal ose, nëse ka filluar, pushohet menjëherë. *Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”* ngarkon strukturat e mbrojtjes së fëmijëve që t’u sigurojnë fëmijëve të njëjtat garanci procedurale, ndihmë dhe shërbime si për të miturit në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, për sa i përket procesit të marrjes në pyetje dhe kontaktit me organet e policisë dhe prokurorisë.

Rregullat e parashikuara në **KDPM** lidhur me të miturit në konflikt me ligjin synojnë:

- të promovojnë riintegrimin e të miturit në konflikt me ligjin penal dhe që i mituri të luajë në shoqëri një rol sa më të dobishëm;
- të garantojnë rishoqërimin dhe rehabilitimin e të miturit që ka kryer veprë penale;
- të parandalojnë përsëritjen e veprave penale prej të miturit;
- të mbrojnë parimet e rendit publik në procesin e administrimit të drejtësisë penale për të mitur;
- të rrisin përgjegjshmërinë dhe profesionalizmin e organeve kompetente në administrimin e çështjeve të drejtësisë penale për të mitur.

KDPM parashikon të drejta dhe detyrime konkrete për NJMF lidhur me trajtimin e të miturit të moshës 14- 18 vjeç. Një pjesë e tyre përmbushen në bashkëpunim me institucione të tjera.

3. Parimet e drejtësisë penale për të mitur

Parimi i interesit më të lartë të fëmijës është parimi bazë që vlerësohet në çdo vendim dhe veprim që ndërmerret për të miturin në konflikt me ligjin. Respektimi i këtij parimi kërkon të mbahen parasysh:

- *nevojat e të miturit për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri, si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;*
- *mendimi i të miturit, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;*
- *historia e të miturit, duke mbajtur parasysh situatat që mund të ketë pasur si: abuzimin neglizhimin, shfrytëzimin ose forma të tjera të dhunës ndaj tij, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin pas rikthimit në familjen e tij;*
- *aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e të miturit për t'iu përgjigjur nevojave të tij;*
- *vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet të miturit dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.*

Bazuar sa më sipër, vendimet dhe aktet që hartohen dhe/ose monitorohen nga NJMF duhet të përmbajnë argumente lidhur me mënyrën se si është analizuar dhe si do të sigurohet respektimi i interesit më të lartë të të miturit nga NJMF.

3.1 Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi

Të drejtat e parashikuara në KDPM zbatohen pa asnjë lloj diskriminimi për çdo të mitur në konflikt me ligjin, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënia, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje tjetër e të miturit, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të të miturit.

3.2 Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi

Të drejtat e parashikuara në KDPM zbatohen pa asnjë lloj diskriminimi për çdo të mitur në konflikt me ligjin, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënia, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje tjetër e të miturit, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të të miturit.

3.3 Parimi i proporcionalitetit

Parimi i proporcionalitetit kërkon që çdo masë që jepet ndaj të miturit në konflikt me ligjin duhet të jetë në raport me rrethanat e kryerjes së veprës penale, personalitetin e të miturit, në përputhje me nevojat që lidhen me moshën, edukimin, arsimimin, kushtet personale, familjare, sociale dhe mjedisore, nevojat zhvillimore, si dhe nevoja të tjera të të miturit. Nevojat e të miturve me aftësi të kufizuara mbahen parasysh në vendimmartjen për të miturin.

3.4 Drejtësia miqësore për çdo fëmijë

Koncepti i drejtësisë miqësore për të miturin është dhënë në Udhëzimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për drejtësinë miqësore për fëmijët (2010). Drejtësia miqësore për fëmijët nënkupton që sistemi i drejtësisë të garantojë respektimin dhe zbatimin e efektshëm të të gjitha të drejtave të fëmijës, në masën më të madhe të arritshme. Drejtësia duhet të jetë e aksesueshme, në përshtatje me moshën, e shpejtë, që adreson nevojat e fëmijës, përfshirë të drejtat për një proces të rregullt, për të marrë pjesë në të dhe për ta kuptuar procesin, për respektimin e jetës private dhe familjare dhe për integritet e dinjitet.

Drejtësia miqësore për të miturin mundëson fillimin e një procesi rehabilitimi sa më të mirë dhe të suksesshëm për të.

3.5 Qasja në drejtësi

Qasja në drejtësi mund të përkufizohet si mundësia për të përfutur zgjidhje të drejtë dhe në kohë për çdo të mitur në konflikt me ligjin dhe trajtimi i tij të bëhet sipas përcaktimeve në normat dhe standardet ndërkombëtare. Çdo i mitur mund të ketë qasjen e duhur në drejtësi nëse njeh të drejtat dhe ka mundësi të kërkojë respektimin e tyre, për shembull përmes edukimit ligjor për të drejtat e fëmijës ose këshillimit, mbështetjes së tyre nga të rritur duke i dhënë njohuritë e nevojshme. NJMF-të i mundësojnë çdo të mituri në konflikt me ligjin mundësinë për të njohur dhe për të marrë shërbime të integruara për rehabilitimin e tij.

Parimet e parashikuara nga KDPM zbatohen nga çdo person dhe organ që punon me të mitur dhe për të miturin, përfshirë të miturin në konflikt me ligjin, në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren lidhur me të miturin në konflikt me ligjin. Pra, parimet e parashikuara në Kod zbatohen edhe në veprimet administrative që NJMF kryen në kuadrin e drejtësisë penale për të mitur.

3.6 Qasja në shërbime cilësore dhe të përshtatura sipas nevojave të çdo fëmijë

Një nga detyrat e NJMF është ofrimi i shërbimeve cilësore dhe sipas nevojave të të miturit në konflikt me ligjin. Që i mituri të ketë akses në këto shërbime, disa pyetje kërkojnë përgjigje:

- A ka në bashkinë tuaj modele të shërbimeve shumëdisiplinore për të miturit që janë në prag lirim dhe që do të mbështeten dhe mbikëqyren pas kryerjes së dënimit ose lirit me kusht?
- Nëse modelet ekzistojnë, a përdoren për çdo të mitur në konflikt me ligjin? A përfshijnë modelet ekzistuese programe që mundësojnë mirëqenien shëndetësore, edukuese dhe psikologjike të të miturit?
- A ka një bashkëpunim efektiv ndërsektorial të përfaqësuesve që do të kontribuojnë në zbatimin e planit të riintegrit të të miturit?
- A ka personeli i NJMF përgatitjen dhe kuafikimin e duhur në çështjet e drejtësisë penale për të mitur?
- A ka marrëveshje të nënshkruara mes institucioneve që do të asistojnë të miturit në prag lirim dhe do ta mbikëqyrin atë pas kryerjes së dënimit ose lirit me kusht?
- A janë miratuar protokolle, procedura dhe mekanizma efektivë që mundësojnë shkëmbimin e informacioneve dhe qartësojnë detyrat e secilit institucion sipas parimit “kush bën çfarë”?
- A veprojnë të gjitha institucionet në kohë dhe shpejt pa krijuar pengesa për institucionet e tjera?

4. Standardet e kujdesit për të miturin në konflikt me ligjin

Kujdesi për përgatitjen për lirim, mbështetje dhe mbikëqyrja e të miturit pas lirimit bazohet në standarde që gjenden në aktet ndërkombëtare ku Shqipëria është palë dhe në **KDPM**. Detajimi i tyre bëhet në aktet nënligjore, rregullore dhe metodologji të miratuara në zbatim të tyre. Standardet janë hartuar bazuar në interesin më të lartë të fëmijës dhe zhvillimin e plotë të tij pas lirimit nga institucioni dhe rikthimit në shoqëri.

I mituri në konflikt me ligjin trajtohet bazuar në rregullat e përcaktuara në **KDPM**, në ligjin *“Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”* dhe në *Udhëzimin Nr. 262. dt 26.05.2021 "Miratimin e metodologjisë së punës për menaxhimin e rastit të fëmijëve në konflikt me ligjin, nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës”*

5. Mekanizmat për mbrojtjen e fëmijeve në kontakt/konflikt me ligjin

Disa institucione dhe organizata të shoqërisë civile që ofrojnë shërbime përfshihen në mbështetjen e të miturit në konflikt me ligjin pas kryerjes së dënimit ose lirimit me kusht. Secila prej tyre ka detyra konkrete, por disa veprime ndërmerren bashkërisht. Kjo kërkon veprim në kohë, bashkërendim dhe bashkëpunim mes gjithë strukturave të përfshira në këtë proces. Sistemi i mbrojtjes së integruar nuk mund të realizohet nëse një nga hallkat e sistemit nuk vepron ose nuk është efektive.

Disa struktura në nivel qendror dhe vendor luajnë rol të rëndësishëm në hartimin e politikave mbështetëse për të miturit në konflikt me ligjin dhe/ose zbatimin e tyre. Strukturat në nivel qendror janë më të fokusuara në hartimin e politikave dhe standardeve të sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës dhe monitorimin e tyre, por në raste të caktuara disa prej tyre ndihmojnë në menaxhimin e rasteve konkrete.

Në nivel qendror, organet që përfshihen janë: *Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës*, *Ministri përgjegjës për çështjet e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*, *Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF)*, *Avokati i Popullit (AP)*, *Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)*, *Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDMDHP)*, *Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR)*.

Në nivel vendor, organet që kontribuojnë në përgatitjen për lirim dhe mbështetjen e fëmijës janë: Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës, Bashkia, struktura përgjegjëse për Shërbimet Shoqërore, grupet e profesionistëve, Policia e Shtetit, Gjykatat, Prokuroritë, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Shërbimi i Provës, organizata të shoqërisë civile që ofrojnë shërbime për të miturit. *Një strukturë e rëndësishme që mblidhet sipas rastit (ad hoc) është Grupi Teknik Ndërsektorial, në nivel Bashkie apo Njësie Administrative.*¹

¹ Mendimi i punonjësve të NJMF është me rëndësi në lidhje me GTN. Ka mendime që GTN nuk përfshihet në trajtimin e të miturit në prag të kryerjes të lirimit ose pas lirimit.

5.1 Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është organ këshillimor dhe bashkërendon politikat shtetërore për garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fushat, veçanërisht të drejtësisë, shërbimeve shoqërore, arsimit, shëndetësisë dhe kulturës. Duke qenë se në Këshill marrin pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, Avokatit të Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shoqatat për autonomi vendore dhe fëmijë me statusin e vëzhguesit, ky Këshill kontribuon në adresimin e problemeve që hasen në zbatimin e programeve të mbrojtjes së të miturit në konflikt me ligjin.

NJMF ka mundësi të adresojë problematikat që hasen në praktikë sidomos lidhur me bashkërendimin mes institucioneve, në lidhje me programet e mbrojtjes së fëmijës kur konstatohen mungesa të shërbimeve dhe programeve të orientuara për fëmijët dhe familjet e tyre dhe atyre parandaluese ndërsektoriale për mbrojtjen e fëmijës, ose probleme me legjislacionin në fushën e mbrojtjes së fëmijës. Këshilli ka detyrë të bëjë rekomandime për krijimin e shërbimeve dhe programeve dhe/ose përmirësimin e ligjeve.

5.2 Ministri përgjegjës për Çështjet e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Krahas përgjegjësi të hartimit të politikave dhe të monitorimit të tyre lidhur me mbrojtjen e fëmijës, ministri në bashkëpunim me ministrat e tjerë merr masa për ngritjen dhe mirëfunksionimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase për mbrojtjen e tyre nëpërmjet shërbimeve shumëdisiplinore, ndërsektoriale, të koordinuara që kanë në qendër fëmijën. Ai nxjerr udhëzime metodologjike për veprimtarinë e strukturave të mbrojtjes së fëmijës në organet e vetëqeverisjes vendore; bashkërendon punën me autoritetet shtetërore përgjegjëse për hartimin dhe plotësimin e standardeve për mbrojtjen e fëmijës; siguron ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës, etj.

5.3 Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

ASHDMF është institucioni qendror përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës. Ndër të tjera, ASHDMF i ofron mbështetje të drejtpërdrejtë strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, nëse kanë nevojë të koordinohen me agjencitë e tjera shtetërore dhe private;

asistencë për menaxhimin dhe zgjidhjen e rasteve të caktuara të fëmijës në nevojë për mbrojtje; si edhe supervizionin, në raste të caktuara, për bashkërendimin e punës në raste ndërshtetërore të mbrojtjes së fëmijës; këshillimin e agjencive shtetërore qendrore dhe vendore, si dhe të punonjësve që punojnë në institucione publike e private për ndihmën e fëmijës në rrezik ose në nevojë për mbrojtje.

5.4 Avokati i Popullit

Avokati i Popullit është një organ kushtetues i pavarur që mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. Pranë tij funksionon Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve dhe Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues. Ky i fundit vëzhgon rregullisht trajtimin e individëve, përfshirë të miturit në konflikt me ligjin, të cilëve u është hequr liria në vendet e ndalimit, paraburgimit dhe në burgje dhe paraqet rekomandime me qëllim përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të individëve që u është hequr liria për të parandaluar torturën dhe trajtimin ose dënimin egër, çnjerëzor ose poshtërues. Mekanizmi pranon kërkesa ose ankesa nga të miturit ose përfaqësuesit e tyre ligjorë dhe organizatat të cilat e ushtrojnë këtë të drejtë pasi të jetë dhënë pëlqimi paraprak nga ana e të dënuarit ose të paraburgosurit.

5.5 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është një institucion i pavarur që mbështet çdo individ që përballet me diskriminimin. Komisioneri shqyrton ankesat dhe vendos sanksione ndaj personave që diskriminojnë të tjerët, si dhe informon rreth të drejtave të tyre me qëllim që çdo individ të gëzojë të drejtat e tij për barazi dhe mbrojtje nga diskriminimi. I mituri në konflikt me ligjin ka të drejtë të adresojë ankesa gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit dhe më pas.

5.6 Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është institucion i pavarur i administratës publike që mbikëqyr dhe monitoron respektimin e së drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat e të miturit në konflikt me ligjin mbrohen gjatë gjithë fazave që i mituri është në kontakt me sistemin e drejtësisë dhe gjatë qëndrimit në institucion. Institucionet dhe profesionistët që punojnë me dhe për të miturit gjatë komunikimeve dhe shkëmbimit të të dhënave të të miturit kujdesen që të dhënat personale dhe jeta private e të miturit të mbrohen dhe të mos publikohen.

6. Institucionet e angazhuara në mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e fëmijëve

6.1 Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR)

QPKMR filloi të funksionojë në vitin 2021 me qëllim mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e të miturve dhe të rinjve pas kryerjes së dënimit për veprën penale të kryer prej tyre dhe është një institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Qendra bashkëpunon ngushtësisht me shumë institucione, përfshirë NJMF për përgatitjen për lirim, mbështetjen gjatë liritimit pas kryerjes së dënimit dhe liritimit me kusht të të miturit në konflikt me ligjin. Gjithashtu, QPKMR ka fushë përgjegjësie parandalimin e kriminalitetit dhe recidivizmit të të miturit dhe të rinjve nëpërmjet aktiviteteve dhe fushatave sensibilizuese në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit të komunitetit. *Veprimtaria e QPKMR rregullohet nga KDPM dhe një sërë aktesh nënligjore të miratura si për shembull vendimi i Këshillit të Ministrave nr 314, datë 15.5.2019 i ndryshuar “Për organizimin, funksionimin si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”.*

6.2 Policia

Policia është kontakti i parë të miturit në konflikt me ligjin. I mituri mund të ndalohet ose të arrestohet kur dyshohet ose kapet në kryerje e sipër të një vepre penale dhe të dërgohet në ambientet e policisë. *Sipas KDPM, policia ka detyrimin të njoftojë menjëherë NJMF në rastet kur a) përfaqësuesi ligjor i të miturit nuk mund të gjendet; b) ka të dhëna që përfaqësuesi ligjor i të miturit ka abuzuar me të miturin ose në rastin e një krimi në familje; c) ka dyshime lidhur me paanshmërinë e përfaqësuesit ligjor të të miturit për sa i përket natyrës së marrëdhënieve të tij me pjesëtarin e familjes, i cili është dëmtuar; ç) ekziston një nga llojet e konfliktit të interesit.*

I mituri përfaqësohet nga mbrojtësi procedural kur: a) përfaqësuesi ligjor i të miturit nuk gjendet brenda një ore nga sjellja e të miturit në mjediset e policisë; b) i mituri nuk jeton me përfaqësuesin e tij ligjor dhe/ose refuzon ta kontaktojë atë; c) përfaqësuesi ligjor vepron në kundërshtim me interesat e të miturit; ç) i mituri është viktimë ose dëshmitar i një vepre penale të kryer nga përfaqësuesi i tij ligjor; d) përfaqësuesi ligjor akuzohet për të njëjtën vepër penale që akuzohet i mituri; dh) përfaqësuesi ligjor nuk është i disponueshëm.

Si përfaqësues procedural caktohet një person nga lista që NJMF ka vënë në dispozicion të policisë në fillim të vitit, duke marrë mendimin paraprapk të të miturit. Në fazën e përgatitjes për lirim e të miturit, policia ka detyrimin të njoftojë viktimën për lirim e të miturit.

6.3 Prokuroria

Prokuroria është organi që bën ndjekjen penale për pjesën më të madhe të veprave penale që parashikohen në Kodin Penal. Gjithashtu, gjykata mund të vihet në lëvizje nëpërmjet kërkesës nga viktimë për disa vepra penale me rrezikshmëri shoqërore të ulët, të parashikuara në nenin 59 të K.Pr.Penale.

KDPM i njej të drejtën prokurorit të vlerësojë nëse ekzistojnë kushtet dhe përmbushen kriteret që i mituri të përjashtohet nga ndjekja penale duke zbatuar masa alternative të shmangies. Për të marrë një vendim të tillë, krahas përmbushjes së kushteve dhe kriterëve ligjore, ligji kërkon pëlqimin e të miturit në konflikt me ligjin dhe vlerësimin e interesit më të lartë të tij.

KDPM parashikon disa detyrime për NJMF në rastet kur shqyrtohet mundësia e shmangies së të miturit nga ndjekja penale. Konkretisht kur i mituri nuk ka përfaqësues ligjor ose kur ai nuk gjendet, ose kur i mituri nuk ka marrëdhënie me të ose përfaqësuesi ligjor ka konflikt interesi me të miturin, rolin e përfaqësuesit ligjor e ushtron përfaqësuesi procedural, i cili në disa raste është një nga punonjësit e NJMF. Ky i fundit duhet të japë pëlqimin për zbatimin e masës së shmangies.

Një detyrim tjetër që buron nga KDPM është marrja e mendimit të NJMF lidhur me përgatitjen e raportit të vlerësimit individual të të miturit. Mendimi merret kur: *prokuroria ose gjykata do të duhet të përcaktojë masën alternative të shmangies, ose do të caktojë dënimin; gjatë ekzekutimit të vendimit të dënimit; dhe kur shqyrtohet kërkesa për lirimin me kusht të të miturit.*

Në rastin e caktimit të masës alternative të shmangies ose të dënimit, raporti hartohet nga një ekspert, një grup ekspertësh ose nga shërbimi i provës, ndërsa për raportet e vlerësimit gjatë ekzekutimit të vendimit të dënimit apo kur shqyrtohet kërkesa për lirimin me kusht, raporti përgatitet nga institucioni i ekzekutimit të dënimit ku gjendet i mituri në bashkëpunim me shërbimin e provës apo vetëm nga shërbimi i provës. *KDPM parashikon se në përgatitjen e raportit merret edhe mendimi i NJMF.*

Sa më sipër, për të pasur një raport vlerësimi individual sa më të mirë dhe të shpejt në kohë me qëllim që të mos pengohet ecuria dhe afatet e hetimit të çështjes, do të ishte e rekomandueshme që të bashkërendohet puna mes këtyre institucioneve për të përmbushur detyrimet sa më shpejt në kohë.

6.4 Gjykata

Gjykata është organi që jep drejtësi. Sipas KDPM, i mituri në konflikt me ligjin gjykohet nga seksionet për të mitur të krijuara pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. Gjyqtarët që caktohen për gjykimin e të miturve duhet të jenë të specializuar dhe të trajnuar për drejtësinë penale për të mitur. Ata gjykojnë të miturin edhe në rast se ky i fundit rezultton të ketë kryer veprën penale në bashkëpunim me një person të rritur. Nëse një gjykatë nuk ka seksion për të mitur, gjyqtari që gjykon të miturin duhet të jetë i specializuar dhe i trajnuar në drejtësinë penale për të mitur.

Gjatë kryerjes së dënimit, i mituri ka të drejtë të ankohet në gjykatë për çdo vendim ose masë që është dhënë ndaj tij si për shembull: masa disiplinore apo kërkesë për lirim me kusht, pra për të mos kryer të gjithë dënimin e dhënë. Po ashtu, gjykata shqyrton çështjen kur i mituri i liruar me kusht nuk përmbush detyrimet dhe ka të drejtë të revokojë vendimin e lirim. *Gjykata rishikon mundësinë e lirit me kusht të të miturit çdo tre muaj, bazuar në kërkesën e të miturit të dënuar.* Në këtë rast, gjykata ka nevojë për vlerësimin e plotë të procesit të rehabilitimit të të miturit së bashku me vlerësimin se kur i mituri është gati për t'u liruar, krahas mendimit të të miturit, mundësisë për ta lënë nën mbikqyrje dhe rekomandimit që bëhet për ta liruar apo për të vijuar të qëndrojë në institucion, rekomandim që jepet nga Shërbimi i Provës dhe institucioni ku është i vendosur i mituri.

6.5 Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP)

KDPM parashikon se i mituri në konflikt me ligjin duhet të vendoset në paraburgim në një seksion për të mitur dhe veçmas nga të rriturit. Në rastet kur gjykata me vendim e dënon të miturin me burgim dhe vlerëson se duhet të qëndrojë në institucion, i mituri vendoset në një institucion të veçantë për të miturit. Gjykata mund të caktojë me vendim që i mituri të vendoset në një institucion ose qendër të caktuar nën mbikqyrje pa u izoluar nga shoqëria dhe komuniteti me qëllim edukimin dhe rehabilitimin e tij duke zbatuar programe të posaçme, për një periudhë jo më shumë se tre vjet.

Aktualisht, në Shqipëri ka një institucion për të miturit në konflikt me ligjin, që ndodhet në Kavajë. Trajtimi i të miturit të dënuar në institucion rregullohet nga KDPM dhe ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e personave të paraburgosur dhe të dënuar”.

Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë rregulla të detajuara për trajtimin e të miturit në konflikt me ligjin.

Përsa i përket përgatitjes për lirim të të miturit, administrata e institucionit ka disa detyrime që kanë të bëjnë me rikthimin e lehtë dhe gradual të të miturit nga jeta në një institucion të mbyllur në familje dhe komunitet.

6.6 Shërbimi i Provës

Shërbimi i provës është organi shtetëror, përgjegjës për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe urdhërimeve të prokurorit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative, të masave të shmangies nga ndjekja penale, të dënimeve jo me burgim për të miturit, ose veprimtarive të tjera sipas akteve të tjera ligjore, si dhe trajtimin e individualizuar të nevojave dhe aftësive të personit nën mbikëqyrje për të siguruar rehabilitimin dhe riintegrimin e tij në shoqëri. Objektivi kryesor i institucioneve, shërbimeve dhe mjediseve përgjegjëse për kujdesin, arsimimin dhe mbrojtjen e fëmijëve duhet të jetë sigurimi, në masën maksimale të mundshme, i mbijetesës, zhvillimit dhe mirëqenies së fëmijëve.

6.7 Bashkitë

Bashkitë janë njësi territoriale administrative që funksionojnë në bazë të ligjit për organet e vetëqeverisjes. Ato janë përgjegjëse për ngritjen dhe funksionimin e strukturave për mbrojtjen e fëmijës në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative në varësi të tyre, duke mbajtur parasysh standardet si dhe të krijojnë një sistem të integruar të mbrojtjes së fëmijës. Çdo bashki harton planin vendor, programe dhe projekte në të cilat duhet të gjejnë pasqyrim dhe të respektohen të drejtat e fëmijëve; parashikon fondet për realizimin progresiv të të drejtave të fëmijës; zhvillon programe dhe projekte për të garantuar të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës, për parandalimin dhe reduktimin e faktorëve që vënë në rrezik jetën dhe integritetin moral, fizik, psikologjik e emocional të fëmijës.

Bashkia zbaton procedurën për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje; dhe krijon programe dhe shërbime rehabilituese e riintegruese për fëmijët në nevojë për mbrojtje, me një fokus të veçantë për fëmijët viktime të dhunës, abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit dhe fëmijët që dyshohen apo kanë kryer vepra penale, të cilët janë nën moshën për përgjegjësi penale.

6.8 Grupi teknik ndërsektorial (GTN)

GTN është strukturë ad-hoc për trajtimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje në çdo bashki dhe në çdo njësi administrative në nivel vendor, e cila ka mbi 3000 fëmijë. GTN mbështet punonjësin e mbrojtjes së fëmijës dhe njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit për vlerësimin e rastit, hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes, lehtëson referimin e tij, si dhe zbatimin e ndërhyrjeve apo veprimeve të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes.

GTN ka në përbërje përfaqësues të strukturave të policisë, strukturave të shërbimeve sociale, përfaqësues të strukturave arsimore, shëndetësore, të drejtësisë, të organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo specialist tjetër që ka njohuri për situatën e fëmijës ose që mund të kontribuojë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës, të cilët janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet e grupit teknik ndërsektorial.

Në takimet e grupit teknik ndërsektorial thirren të marrin pjesë: anëtarët e nevojshëm për menaxhimin e rastit të fëmijës në rrezik, prindërit ose anëtarët e familjes ose kujdestarët e fëmijës; fëmija, bazuar në moshën dhe në aftësinë e tij për të kuptuar dhe duke marrë në konsideratë mbrojtjen e interesit më të lartë të tij. Gjyqtarët dhe prokurorët, si përfaqësues të organeve të drejtësisë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin ku bën pjesë bashkia ose njësia administrative, ftohen të marrin pjesë në takimet e grupit teknik ndërsektorial, jo me statusin e anëtarit përfaqësues.

6.9 Strukturat e ofrimit të ndihmës juridike falas

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” mundëson ndihmën juridike falas, të garantuar nga shteti për personat që nuk kanë mundësi ekonomike duke garantuar akses të barbartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë. Fëmijët përfitojnë ndihmë juridike falas, pavarësisht mundësive ekonomike të familjes së tyre. Drejtoria e Ndhmës Juridike është struktura qendrore që administron qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, pranë ambienteve të gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme; si dhe publikon listën e avokatëve, të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas. Ajo lidh kontrata me organizata jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore. Në nivel vendor janë krijuar disa qendra të ofrimit të ndihmës juridike falas. Në faqen zyrtare të saj publikohet lista e avokatëve të miratuar për të dhënë ndihmë juridike dhe adresat e qendrave të ndihmës juridike (<https://ndihmajuridike.gov.al/>).

6.10 Mbrojtësi i të miturit në konflikt me ligjin

Sipas KDPM, pjesëmarrja e mbrojtësit është e detyrueshme në çdo veprim procedural që kryhet në lidhje me të miturin në konflikt me ligjin. Mbrojtësi zgjidhet ose caktohet nga përfaqësuesi ligjor i të miturit, në mënyrë të pavarur, duke marrë parasysh interesin më të lartë të të miturit. Në rast se i mituri në konflikt me ligjin nuk ka zgjedhur mbrojtës, policia, prokurori ose gjykata (në varësi se kush kryen veprimin përkatës procedural), cakton menjëherë mbrojtësin nga lista e avokatëve të regjistruar si avokatë që ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti.

Nëse punonjësi i NJMF luan rolin e përfaqësuesit procedural të të miturit në konflikt me ligjin, ai duhet të japë pëlqimin për caktimin e mbrojtësit të të miturit, kur i mituri nuk e ka dhënë pëlqimin, si dhe firmos procesverbalin ku janë shënuar kërkesa për caktimin e mbrojtësit, marrja dijeni e të miturit dhe dhënia e pëlqimit të të miturit.

Krahas mbrojtësit, prania e përfaqësuesit ligjor dhe psikologut është e detyrueshme. Përfshirja nga ky rregull bëhet vetëm në rastet kur veprimet ose mosveprimet e të miturit rrezikojnë sigurinë publike ose në rastet se i mituri kapet në flagrancë. Ndërsa, në fazën e hetimit dhe gjatë gjykimit përfaqësuesi ligjor i të miturit në konflikt me ligjin mund të ndalohej të marrë pjesë në një veprim procedural vetëm nëse një gjë e tillë është në interesin më të lartë të të miturit.

Mbrojtësi ligjor përfaqëson të miturin dhe parandalon çdo sjellje ose veprim që e stigmatizon atë. KDPM ka parashikuar që fëmija merr pjesë në të gjitha fazat e procesit, dëgjohet dhe mendimi i tij respektohet. Mund të ndodhë që i mituri duke mos kuptuar rëndësinë e mbështetjes ose mbikëqyrjes pas lirit mund të refuzojë të bashkëpunojë me përfaqësuesit e institucioneve që ofrojnë mbrojtje për të. Në një rast të tillë, mbrojtësi, nga njëra anë respekton mendimet e të miturit, por nga ana tjetër, duhet të krijojë një marrëdhënie besimi dhe ta përdorë atë që të ndikojë te fëmija që fëmija të kuptojë përparësitë dhe pasojat pozitive në rast bashkëpunimi dhe të veprojë sipas interesit më të lartë të tij.

Bashkëpunimi i profesionistëve, përfshirë edhe përfaqësuesit e NJMF-ve me të miturin në konflikt me ligjin do të jetë i suksesshëm, nëse mbrojtësi është i trajnuar në çështjet e drejtësisë penale për të mitur, ka aftësitë e komunikimit dhe përfaqësimit miqësor të tij; ka njohuri për shërbimet e integruara të mbrojtjes së të miturit dhe lehtëson bashkëpunimin mes të miturit që përfaqëson dhe përfaqësuesve të institucioneve që do ta asistojnë të miturin.

6.11 Ndërmjetësuesit

Programet e drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit zënë një vend të veçantë në trajtimin e të miturit në konflikt me ligjin. KDPM i parashikon ato si masa alternative të mundshme për të shmangur të miturin nga ndjekja penale, për t'i dhënë mundësinë atij të korrigjojë pasojat e veprës penale të kryer, si dhe për të mundësuar përmirësimin e marrëdhënieve mes të miturit dhe viktimës së veprës penale.

Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, e krijuar në bazë të ligjit për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ka për detyrë të: rregullojë dhe kontrollojë ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit në gjithë vendin, hapë ose mbyllë degët vendore; hartojë dhe sigurojë pjesëmarrjen e ndërmjetësve në programet e trajnimit fillestar dhe vazhdues; kujdeset për ndërgjegjësimin dhe informimin e nevojshëm të publikut për veprimtarinë e ndërmjetësimit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe për mundësitë e kontaktimit të ndërmjetësve.

Në rastet kur i mituri përgatitet të lirohet me kusht, një nga elementët e raportit të vlerësimit individual të tij është normalizimi i marrëdhënieve me viktimën. Prandaj, çdo i mitur duhet të ketë akses në programet e drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit dhe të informohet për përshirjen në këto programe dhe përfitimet prej tyre. Nëse këto programe nuk janë të disponueshme në nivel vendor, rehabilitimi dhe riintegrimi i të miturit do të hasë vështirësi dhe i mituri mund të mos pranohet lehtësisht në komunitet.

Autoritetet shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për bashkëpunim me ministrin që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, në hartimin e politikave dhe programeve të përbashkëta në këtë fushë.

7. Përgatitja për lirim, kujdesi, rehabilitimi dhe rishoqërimi

Hyrje

Përgatitja për lirim e të miturit në konflikt me ligjin është një mundësi për çdo të mitur në konflikt me ligjin, të cilit i është kufizuar liria duke i vendosur në një institucion të posaçëm për të miturit ose nën mbikqyrjen e Shërbimit të Provës. I mituri ndihmohet për të kaluar sa më lehtë nga jeta e tyre në institucion ose nën mbikqyrje te jeta në komunitet. Kjo fazë është rregulluar në KDPM dhe në disa akte nënligjore.

Ligji parashikon rolin e NJMF pas kryerjes së dënimit nga i mituri ose lirimi me kusht në tre aspekte:

1. Përgatitja për rikthim pas kryerjes së dënimit;
2. Mbështetja pas lirim;
3. Mbikëqyrja pas kryerjes së dënimit ose dënimit me kusht;

Dënimi me burgim vlerësohet i plotësuar dhe i dënuari lirohet kur:

- a) përfundon kryerjen e dënimit;
- b) i falet dënimi I mbetur;
- c) amnistohet vepra penale ose dënimi I mbetur;
- c) lirohet me vendim gjykate.

Falja e dënimit bëhet me vendim gjykate ose në bazë të ligjit për faljet. Të miturit në konflikt me ligjin më shpesh kanë përfituar nga amnistitë sesa faljet. Aministia miratohet nga Parlamenti. Me aktin e amnistisë, i mituri mund të përfitojë nga amnistimi i veprës penale dhe/ose e dënimit. Kur amnistohet vepra penale, i mituri që gjendet në paraburgim lirohet, procedimi penal i filluar pushon ose nëse nuk ka filluar, nuk fillon. Aministia mund të falë një pjesë të dënimit të mbetur pa u kryer nga i mituri ose të gjithë dënimin për disa vepra penale, si rregull ato me rrezikshmëri shoqërore të ulët. Mosnjohja e një dite të saktë të lirim të të miturit, në rast amnistie, tregon sesa rëndësi ka fillimi i rehabilitimit të të miturit që në ditën e pranimit në institucion, rishikimi i planit individual të trajtimit në institucion dhe përshtatja e tij me ecurinë e sjelljes dhe nevojat e të miturit.

Përgatitja për lirim e të miturit realizohet përmes formave të ndryshme të ndërhyrjes të cilat përfshihen në planin individual të të miturit dhe zbatimi i tij fillon shumë kohë para lirim të të miturit nga institucioni ose mbikëqyrja.

Roli i NJMF për përgatitjen e të miturit për rikthim pas kryerjes së dënimit

- Informimi mbi kohën e lirimit

Koha, mënyrat e njoftimit dhe bashkëpunimi mes institucioneve varet nga arsyet e mbarimit të dënimit. NJMF njoftohet paraprakisht për datën e mbarimit të dënimit të të miturit. Ligji kërkon që ky njoftim të bëhet pasi i mituri ka kryer dy të tretat e dënimit me burgim, por jo më pak se tre muaj para datës së mbarimit të dënimit. Ky afat lidhet me momentin kur të miturit i krijohet mundësia ligjore të kërkojë dhe të përfitojë lirin me kusht.

- Përgatitja për lirim

Kodi parashikon rregulla të veçanta për përgatitjen për lirim të të miturit. Sikurse është thënë edhe më lart, përgatitja për lirim fillon që në momentin kur i mituri pranohet në institucion. Momenti i parë i përfshirjes së NJMF është momenti i pranimit të të miturit në institucion dhe bashkëpunimi me administratën e institucionit, me fëmijën dhe familjen e tij për të hartuar planin individual të rehabilitimit të të miturit dhe vijon me kontributin për përditësimin e tij gjatë kohës që i mituri qëndron në institucion (neni 133&2 i KDPM). Ligji kërkon që plani të hartohet me një gjuhë të kuptueshme për të miturin. Kjo kërkon që të mbahen në konsideratë shkalla e zhvillimit dhe të kuptuarit nga i mituri dhe nevoja specifike të tij. *Kujdes i kushtohet të miturve me nevoja të kufizuara, atyre që i përkasin komunitetit LGBTIQ+, të huaj, dhe të miturve.*

Fillimi i përgatitjes për lirim sa më shpejt që të jetë e mundur dhe domosdoshmëria e miratimit të një strategjie sistematike të hapave gradualë drejt riintegritimit social.

Përgatitja për lirim përfshin forma të ndryshme të ndërhyrjes që përfshihen në planin individual të trajtimit të të miturit në konflikt me ligjin. Plani individual zbatohet në kohën e duhur para kryerjes së dënimit dhe lirimit të të miturit. NJMF fillon të përfshihet pa dalë i mituri nga institucioni.

- Institucionet që përfshihen në përgatitjen për rikthimin pas kryerjes së dënimit

Institucionet që përfshihen në përgatitjen për rikthimin pas kryerjes së dënimit

Disa institucione, profesionistë dhe struktura që bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në përgatitjen e të miturit në konflikt me ligjin për rikthimin e tij në familje dhe në shoqëri. Ato kanë role specifike dhe disa të përbashkëta. Institucionet janë:

Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur

Njësia për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës

Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve;

Shërbimi I provës

Krahas tyre, mund të përfshihen familja e të miturit, nëse ka një të tillë, përfaqësuesi ligjor ose përfaqësuesi procedural, organizatat e shoqërisë civile që ofrojnë shërbime për fëmijët, strukturat arsimore dhe/ose të formimit profesional, struktura shëndetësore ose struktura të tjera në varësi të nevojave të të miturit.

Roli i institucioneve

Institucioni i ekzekutimit të vendimit penal (IEVP)

IEVP mund të jetë një institucion ku i mituri kryen dënimin e caktuar nga gjykata ose një institucion/qendër ku vendoset i mituri për të cilin gjykata ka vendosur kufizimin e lirisë, por pa izolimin e tij nga shoqëria dhe komuniteti.

IEVP ku ndodhet i mituri, para përmbushjes së afatit të kryerjes së dënimit:

- informon për datën e mbarimit të dënimit të miturin, NJMF, përfaqësuesin ligjor të të miturit dhe QPKMR;

- i jep mbështetje psikologjike dhe arsimore të miturit për t'u përgatitur për lirim;

- i jep mundësi të miturit që të bëjë vizita të shkurtra në shtëpi; përgatit një fashikull me të dhënat mbi situatën sociale të të miturit, me qëllim që të përforcojë rishoqërimin e mëvonshëm të të miturit;

- i jep informacion të miturit në mënyrë të kuptueshme për të, me qëllim që ai të ketë aksesin e duhur për mbështetje dhe ndihmë pas kryerjes së dënimit;

- bashkëpunon me organin shëndetësor në vendin e banimit të të miturit në mënyrë që të zbatohet plani i riintegritimit për aspekte që mund të lidhen me anën shëndetësore të të miturit.

Një nga problemet që mund të haset në praktikë është pamundësia e ushtrimit nga i mituri i vizitave në familje, kur familja e tij vlerësohet e papërshtatshme ose i mituri nuk ka familje. Në raste të tilla, ka rëndësi vendosja e kontakteve me të miturit dhe organizatave që ofrojnë shërbime për të miturit ose me grupin e profesionistëve që menaxhojnë rastet e të miturve të përfshirë në krim.

Bashkëpunimi i NJMF me QPKMR

NJMF në bashkëpunim me QPKMR dhe shërbimet në bashki duhet të punojnë ngushtësisht së bashku që nga vendosja e të miturit në institucion për t'i mundësuar të miturit një familje kujdestare ose të gjejnë një strehim ku do të qëndrojnë i mituri pas daljes nga institucioni.

Njoftimi INJMF

Institucioni ku ndodhet i mituri njofton NJMF që ndodhet në njësinë administrative ku i mituri banon ose do të banojë.

Njoftimi bëhet brenda intervalit të kohës, pasi i mituri ka kryer dy të tretat e dënimit me burgim, por jo më pak se tre muaj para datës së mbarimit të dënimit. Pra, njoftimi duhet të jetë berë të paktën tre muaj para lirimit të të miturit.

NJMF dhe QPKMR luajnë një rol të rëndësishëm në këtë fazë. Menjëherë me marrjen e njoftimit për datën e mbarimit të dënimit, përfaqësuesi i QPKMR komunikon me NJMF dhe së bashku kryejnë disa detyra.

a) Komunikimi me të miturin

I mituri kontaktohet nga punonjësi QPKMR dhe i komunikohet dhe shpjegohet kushtet dhe kërkesat e planit të rishoqërizimit dhe rehabilitimit me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për moshën, të nxëniet dhe nevojat e veçanta të të miturit. Në këtë fazë është me rëndësi që i mituri të kuptojë vlerat e zbatimit të një plani për rishoqërizimin e tij, përfitimet dhe cilat do të jenë angazhimet e tij. I mituri ka të drejtë të dëgjohet dhe të shprehë lirshëm mendimin e tij si dhe të bashkëpunojë në hartimin e planit, por pa e imponuar. Do të ishte e dobishme që i mituri të krijojë bindje për dobishmërinë e përfshirjes në program. Në këtë fazë NJMF merr pjesë dhe komunikon me të miturin.

b) Familjarizimi me fashikullin e të miturit

Institucioni ku ndodhet i mituri krijon një dosje personale të të miturit që në momentin e pranimit të tij në institucion dhe e pasuron në vijimësi atë. Planin individual i trajtimit të të miturit hartohet në bashkëpunim me të miturindhe nëse vlerësohet e përshtatshme dhe me familjen. Ai përfshin informacione me interes për adresimin e nevojave të tij: arsimimin; kurse profesionale; trajnim për aftësim social; edukim qytetar; menaxhim të agresionit ose zemërimit; terapi kundër varësisë nga substancat narkotike/psikotrope apo alkooli; terapi individuale apo në grup; edukim fizik dhe sporte; programe të drejtësisë restauruese dhe riparuese për veprën penale të kryer; aktivitetet krijuese të kohës së lirë; veprimtari jashtë institucionit në komunitet, dhënia e lejeve ditore apo formave të tjera të lejeve; përgatitja për lirim dhe riintegrim. Planin i trajtimit zbatohet dhe përditësohet rregullisht me pjesëmarrjen e të miturit, të mësuesve dhe aq sa është e mundur të prindit dhe të përfaqësuesit ligjor.

Vlerësimi i faktorëve të riskut dhe motivimi që ka patur i mituri për t'u përfshirë në veprimtaritë që organizohen në institucion kanë rëndësi për të orientuar mbështetjen e të miturit pas lirimit.

IEVP vë në dispozicion të përfaqësuesit të NJMF dhe QPKMR fashikullin e përgatitur me të dhënat për përfshirjen sociale të të miturit në mjediset e ndalimit ose të burgimit. NJMF dhe QPKMR familjarizohen me fashikullin e përgatitur para se të fillojnë të hartojnë planin e mbikqyrjes së të miturit.

c) Takimi i të miturit

Takimi i përfaqësuesit të NJMF dhe QPKMR me të miturin bëhet në një mjedis të përshtatshëm. Gjatë takimit, diskutohet dhe bashkëpunohet me të miturin për të hartuar planin e rishoqërimit që adreson nevojat e tij. Me rëndësi është informimi i të miturit me një gjuhë të kuptueshme për rëndësinë që ka mbikëqyrja dhe përfitimet që sjell për të miturin. I mituri ka nevojë të krijojë bindjen për vlerën dhe nevojën e hartimit të një plani rehabilitimi dhe riintegrimi në jetën e tij. Informimi përmban informacione për llojet e mbështetjes që përfiton i mituri bazuar në nevojat individuale të tij.

ç) Përgatitja e planit të rishoqërimit dhe rehabilitimit të fëmijës pas përfundimit të dënimit

Plani individual përgatitet nga institucioni ku është i vendosur i mituri në bashkëpunim me QPKMR, organet e qeverisjes vendore të njësisë administrative dhe NJMF ku i mituri banon ose ka planifikuar të banojë.

Disa hapa kërkohen të ndërmerren në menaxhimin e punës për hartimin e planit:

- kontaktimi i të miturit në institucion për ta informuar për mundësitë dhe mësuar nevojat specifike të tij;*
- informacioni për vendin e banimit (nëse do të kthehet në familje), nëse nuk ka mbështetje ku do të vendoset dhe mbikqyrjet;*
- evidentimi i nevojave të të miturit dhe mënyra e adresimit të tyre;*
- ekzistenca e shërbimeve të integruara në bashkinë ose në njësinë ku i mituri do të banojë;*
- përfshirja e programeve në planin individual dhe zbatimi i tyre para lirimit.*

d) Rishqyrtimi i programeve në mjediset e institucionit ku ndodhet e mituri

Ndonëse i mituri ndodhet ende në institucion, punonjësi shërbimit social në institucion bashkëpunon me QPKMR dhe NJMF për rishqyrtimin e programeve të miratuara, kur vlerësohet se procesi i përgatitjes së të miturit nuk po ecën sipas pritshmërive.

Sipas KDPM (neni 133&6), QPKMR siguron pëmbushjen e masave të parashikuara në program dhe rishqyrtimin e tyre. Ky proces kryhet në bashkëpunim me NJMF. Ligjvënësi ka parashikuar një kalim gradual të të miturit nga mbikëqyrja e personelit të IEVP-së të profesionistët jashtë tij. Me qëllim unifikimin e praktikave dhe menaxhimit më të mirë të rastit konkret, NJMF dhe QPKMR bëjnë një ndarje konkrete të detyrave që do të kryejë secili përfaqësues. Ndarja e detyrave lehtëson bashkëpunimin dhe shmang mbivendosjen.

e) Miratimi i planit të rehabilitimit dhe rishoqërizimit

Plani i hartuar miratohet jo më vonë se tre muaj nga paraqitja e kërkesës së të miturit për t'u përfshirë në program, në rast se i mituri e kërkon këtë. KDPM kërkon dhënien e pëlqimit nga i mituri për t'u mbikëqyrur pas kryerjes së dënimit.

Plani miratohet nga Institucioni, QPKMR dhe NJMF. Krahas përfaqësuesve të institucioneve, merr pjesë i mituri dhe mbrojtësi i të miturit. Ligji parashikon që mbrojtësi i të miturit mund të jetë mbrojtësi që e ka përfaqësuar atë në fazat e mëparshme të procesit, nëse është në interes të të miturit dhe ky i fundit jep pëlqimin për këtë, ose caktohet një mbrojtës kryesisht. Ky detyrim ligjor kërkon që institucioni duhet të ketë listën e përditësuar të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike për të mitur. Sipas kërkesave të ligjit, ata duhet të jenë në trajnua dhe të specializuar në çështjet e drejtësisë për të mitur.

Bashkëpunimi i NJMF me institucionet në nivel vendor

Nga raportet e vlerësimit të zbatimit të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur 2018-2021 ka rezultuar se shërbimet e integruara për të miturin nuk janë efektive në të gjitha bashkitë e vendit. Disa bashki nuk kanë kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe shërbime të qëndrueshme. Në këto raste, disa shërbime mund të ofrohen nga organizatat e shoqërisë civile. Një nga vështirësitë që mund të haset në bashkitë e vogla është se shërbimet e ofruara nga OJF-të në një fushë të caktuar ku i mituri ka nevojë, ose mungojnë, ose nuk janë të qëndrueshme.

Në kushte të tilla, pasja e hartës së shërbimeve të integruara dhe përditësimi i saj është i nevojshëm. Evidentimi i nevojave dhe plotësimi i tyre me mbështetjes me profesionistë dhe financimit do të mundësojë menaxhimin e të miturve në konflikt me ligjin. Megjithatë, disa struktura të nevojshme për të miturin ekzistojnë në nivel vendor si:

- a)** Njësia arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar;
- b)** Njësia arsimore vendore përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional që ka në varësi shkollat publike profesionale;
- c)** Mësuesi/sja kujdestare në shkollën ku i mituri do të rikthehet;

Këto struktura janë të rëndësishme për të mundësuar ndjekjen e arsimit të detyrueshëm ose të programit mësimor nga I mituri.

Për të miturit që do të ndjekin një program të arsimit dhe formimit profesional dy struktura janë me rëndësi për tu identifikuar dhe angazhuar:

- a)** Drejtuesi i programit mësimor të arsimit dhe të formimit profesional;
- b)** Personeli i angazhuar në mësimdhënie në institucionin përkatës.

Në rast se në planin e integritetit, ka masa që lidhen me ndjekjen e ndonjë programi rehabilitues, si për shembull: trajtim psikologjik ose mjekësor ose detoksikues (në rastet kur fëmija është përdorues alkooli ose droge), disa struktura në nivel vendor përfshihen:

- a)** Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror;
- b)** Urdhëri I Psikologut;
- c)** Shërbimi i Shëndetit Mendor për fëmijët dhe të rinjtë në nivel vendor;
- d)** Institucionet e kujdesit të shëndetit (mjeku i familjes, mjeku specialist, mjekë spitali);

OJF-të dhe shoqëria civile, sektori privat dhe organizimet e tyre mund të jenë partnerë shumë të mirë në integrimin e të miturit, veçanërisht për punësimin e tij dhe/ose plotësimin e nevojave për formim profesional, për mbështetjen e të miturit ose për të kontraktuar shërbime për të miturit që nuk ofrohen nga strukturat vendore të ngarkuara me ofrimin e shërbimeve.

Gjithashtu, arsimimi i detyrueshëm dhe formimi profesional janë të drejta që i mituri i gëzon në institucionin ku është vendosur. Procesi arsimor bazë dhe sipas rastit arsimi i mesëm dhe/ose i lartë rregullohet nga KDPM dhe urdhëri i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe MAS.²

Neni 32/3 I KDPM

Organet kompetente të parashikuara në këtë nen hartojnë dhe përditësojnë regjistrimin e të trajnuarve lidhur me drejtësinë e të miturve.

Roli i Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijës për përgatitjen e të miturit para lirimit me kusht

Sikurse është thënë më lart, dënimi përfundon dhe i mituri lirohet për shkak të vendimit të gjykatës për lirimin me kusht të tij. Lirimi me kusht është një e drejtë pasi i mituri ka kryer një pjesë të dënimit, por jo detyrimisht çdo i mitur e përfiton atë. Pavarësisht kësaj, përgatitja e të miturit para lirimit me kusht është detyrim ligjor për të ndihmuar në riintegrimin e tij në shoqëri.

Lirimi me kusht i të miturit shoqërohet me disa kushte që gjykata vendos në vendimin e saj. Përgatitja për lirimin me kusht organizohet në bashkëpunim të ngushtë me personelin përkatës që punon në institucionin ose qendrën ku është vendosur i mituri dhe me institucionet që do të përfshihen në mbikëqyrjen e të miturit pas lirimit. Pjesa më e madhe e institucioneve të përfshira në menaxhimin e rastit kur i mituri e ka kryer dënimin veprojnë edhe në rastin kur i mituri lirohet me kusht, por me disa ndryshime të vogla.

Shërbimet e institucionit ku gjendet i mituri sigurohen që ai të mund të marrë pjesë në programe të përshtatshme para lirimit dhe e inkurajojnë të miturin të marrë pjesë në programe edukative, si dhe të përfshihet në trajnime relevante që përgatisin atë për jetën në komunitet. Në Shqipëri nuk është krijuar ende institucioni/qendra ku mund të vendosen të miturit me kufizim lirie, por ndërtimi dhe fillimi i funksionimit të tij do të jetë i shëndetshëm për përgatitjen e të miturit për riintegrim.

² Urdhëri i Përbashkët nr.3348/1, datë 18.4.2018 i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (më parë edhe të Rinisë) "Për Rregullat e proçesit mësimor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur"

Përgatitja për lirimin me kusht të të miturit kërkon që ai të mbajë lidhje me të shpeshta me familjen ose t'i rivendosë marrëdhëniet me të. Mund të ndodhë që marrëdhënia e fëmijës me familjen e tij nuk është e mundur. Krijimi i kontakteve me organizatat e shoqërisë civile dhe shoqatat vullnetare që mund të ndihmojnë të miturin e liruar me kusht që të përshtatet me jetën në komunitet është idobishëm. Këto kontakte janë të dobishme edhe për të miturit që kanë mbajtur ose kanë vendosur kontakte me familjen e tyre.

Informimi për datën e lirimit me kusht

Jo më parë se tre muaj para afatit ligjor kur lind e drejta për lirimin me kusht administrata e IEVP për të mitur:

- informon të miturin, përfaqësuesin e tij ligjor dhe Shërbimin e Provës për datën e mbarimit të dënimit;
- informon me shkrim QPKMR, Shërbimin e Provës, Njësinë NJMF për rrezikun familjar dhe shoqëror/ mjedisor dhe për nevojat e të miturit jashtë IEVP-së;
- nëse fëmija është nën mbikqyrjen e Shërbimit të Provës, plani përgatitet nga Shërbimi i Provës në bashkëpunim me QPKMR, organet e qeverisjes vendore të njësive administrative dhe NJMF ku i mituri banon ose ka planifikuar të banojë.

Në rastet e lirimit me kusht të të miturit, përfaqësuesi i Shërbimit të Provës kryen vlerësimin e rrezikut familjar dhe shoqëror/ mjedisor dhe të nevojave të të miturit jashtë IEVP-së.

Shërbimi i Provës vlerëson një sërë rrethanash si: *sjellja e të miturit në institucion dhe ecuria e saj; qëndrimi i të miturit ndaj veprës penale të kryer dhe viktimës; gjendja familjare, sjellja e tij, rrethanat në familje, niveli arsimor, formimi profesional, sjellja e tij; marrëdhëniet e tij në komunitet, vlerësimi i rrezikut të ripërfshirjes në kryerjen e veprave penale nga ana e të miturit, masat e marra për të ulur rrezikun, rrethanat sociale, si dhe mundësitë për riintegrimin e të miturit.*

Shërbimi i Provës bën intervista dhe mbledh të dhëna nga institucione të ndryshme. Bazuar në vlerësimin e kryer, Shërbimi i Provës lëshon dokumentet e nevojshme për lirimin me kusht të të miturit, mbështetur në vlerësimin e rrezikut familjar dhe shoqëror/ mjedisor të të miturit jashtë IEVP-së.

Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë³ përcakton detyrimin që ka specialisti i shërbimit të provës që krahas rekomandimit për lirimin ose jo me kusht të të miturit, të propozojë planin e ndërhyrjes për rehabilitim pas daljes nga institucioni, si dhe përcakton institucionet që duhet të përfshihen për realizimin e planit të rehabilitimit.

NJMF njoftohet nga institucioni për datën e lirimit me kusht të të miturit, për rrezikun familjar dhe shoqëror/mjedisor dhe për nevojat e të miturit pas lirimit. Lirimi me kusht i të miturit shoqërohet me njoftimin dhe sigurimin e jetës dhe shëndetit të viktimës së veprës penale kur i mituri lirohet nga institucioni. Policia e Shtetit njofton viktimën dhe familjarët e tij.

Lirimi me kusht i të miturit shoqërohet detyrimisht me kushtet që duhet të përmbushë ai. Kushtet që vendos gjykata kanë për qëllim që të mbështesin të miturit në procesin e riintegritetit dhe rishoqërizimit., I mituri ndihmohet dhe duhet t'i krijohen kushtet që të përmbushë këto detyrime, të cilat janë të parashikuara në ligj dhe mund jenë një ose më shumë. Për shembull, krahas mbajtjes së kontakteve me Shërbimin e Provës, i mituri duhet të riparojë dëmin, të mos frekuentojë vendetë caktuara (lokale ku shërbehen pije alkoolike), të mos shoqërohet me persona të caktuar, t'i nënshtrohet një programi trajtimi mjekësor, rehabilitues etj.

³ Udhëzimi nr.7640, datë 5.7.2018 "Për përcaktimin e formës dhe rregullave të përgjithshme të përgatitjes së dokumentit për lirimin me kusht të të miturve në dën timer.

8. Mbështetja pas Lirimit

8.1 Llojet e mbështetjes së të miturit

KDPM (neni 134) përcakton mbështetjen e të miturit pas lirimit me qëllim rintegrimin e tij në shoqëri dhe në komunitet. Ndërkohë, nevojat e të miturit përcaktojnë llojin e mbështetjes për të miturit. KDPM përcakton shprehimisht disa forma të mbështetjes që janë kërkesa minimale si: *a) veshje të përshtatshme; b) mbështetje psikologjike; c) shpenzimet e udhëtimit për në banesë; ç) mundësimin e ndjekjes së kurseve të formimit profesional, përveç rasteve kur ai mbështetet nga familja.*

a) Sigurimi i veshjes së përshtatshme

Termi “veshje e përshtatshme” nënkupton veshje qëi përshtaten moshës, gjinisë, kohës së lirimit (dimër, verë, vjeshtë, pranverë). Veshja duhet të jetë e përshtatshme për moshën, stinën dhe motin. Veshja sigurohet nga njesitë e qeverisjes vendore në bashkëpunim me NJMF. Këto të fundit mund të bashkëpunojnë me shoqata, fondacione dhe sektorin privat që mund të lehtësojnë këtë proces.

b) Mbështetja psikologjike

Mbështetja psikologjike ofrohet nga psikologë të licensuar dhe të specializuar në çështjet e të miturve. Shërbimet e bashkisë ose të njësisë administrative ku banon fëmija kontribuojnë në këtë proces. Mbështetja psikologjike është falas.

c) Mbështetja e të miturit për kthimin në familje

Mbështetja e të miturit për kthimin në familjen e tij ose në gjetjen e një familjeje kujdestare, si dhe lehtësimi i zhvillimit të marrëdhënieve shoqërore janë pjesë e programit të mbështetjes së të miturit. KDPM nuk e trajton mënyrën sesi realizohet, por i referohet përcaktimeve në ligjin për të të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

ç) Mbështetja e të miturit për strehim

Praktika ka treguar se ka të mitur që nuk kanë familje ose familja nuk është e përshtatshme për të. NJMF në bashkëpunim me strukturat përkatëse mundësojnë strehimin e përshtatshëm për të miturin që nuk ka strehim. Strehimi zgjidhet kohë përpara ditësnë të cilën i mituri përfundon dënimin dhe lirohet.

Nëse i mituri nuk ka familje, nuk mund të kthehet në familje për shkak të rrethanave, apo nuk ka familje kujdestare, NJMF bashkëpunon me strukturën përgjegjëse në bashki për gjetjen e strehimit.

Ligji nr. 22/2018 “Për Strehimin Social” i jep të drejtë të miturit nën moshën 18 vjeç, për të përfituar nga programi i banesave sociale të specializuara, pas lirimit ose përfundimit të programit të masës alternative të shmangies, në rastin kur bazuar në një vendim gjyqësor ose një akt administrativ, mbeten të pastrehë për arsye se nuk duhet të jetojnë me prindërit, kujdestarin ligjor ose me familjen e tyre.

Në banesat e specializuara për të miturit dhe të rinjtë ofrohet shërbimi i psikologut ose punonjësit social, për të siguruar monitorimin e tyre, me qëllim integrimin dhe rishoqërimin në komunitet. Banesat e specializuara për të miturit pajisen me shërbimin e kujdestarisë për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të tyre për arsimim, shëndetësi, mirëritje, punësim, me qëllim integrimin dhe rishoqërimin në komunitet. Banesat e specializuara sociale për të miturit (14-18 vjeç) dhe të rinjtë (18-21 vjeç) duhet të pajisen me infrastrukturën e nevojshme për njoftimin e policisë në raste rreziqesh ose emergjencash.

Nëse në një Bashkinuk ekziston programi i banesave të specializuara për të miturit nga mosha 14 deri në 18 vjeç pas lirimit ose kryerjes së programeve rehabilituese, atëherë NJMF-të në bashkëpunim me drejtorinë përkatëse të strehimit dhe OJF-të mundësojnë një strehim në mjedis të sigurt të fëmijës dhe shërbimet e nevojshme për të miturin në banesë.

Ligji njetë të drejtën e subvencionit të qirasë të banesës për të miturit (14-18 vjeç) dhe të rinjtë (18-21 vjeç) në konflikt me ligjin kur dalin në lirim pas kryerjes së dënimit apo kur kanë nevojë për banesë, sepse duhet të jetojnë larg familjeve, për shkak të rehabilitimit të tyre më të mirë në shoqëri.

Banesat e specializuara për të rinjtë nga 18-21 vjeç jepen me qira, në rastin kur këta nuk kanë banesë ose kur referohet nga shërbimet sociale dhe Shërbimi i Provës që ata duhet të jetojnë veçmas nga familjet e tyre. Në rastin kur të rinjtë nuk janë në marrëdhënie pune, banesa jepet në huapërdorje derisa njësia e vetëqeverisjes vendore të mund të sigurojë punësimin e tyre.

d) Mundësimi i vazhimit të arsimimit e të trajnimeve profesionale

Ligji nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” është një mundësi e mirë për t’u përdorur në kuadër të arsimimit dhe formimit profesional të të miturit në konflikt me ligjin. Si rregull, procesi mësimor për fëmijët në konflikt me ligjin ofrohet brenda institucionit ose jashtë tij. I mituri i dënuar nuk duhet të shkëpusë procesin mësimor që fillonose vijon në institucion dhe institucioni ku ai gjendet duhet të ofrojë arsimin e detyrueshëm falas, e sipas rastit arsimin e mesëm dhe të lartë.

Urdhëri i përbashkët i Ministrit të Drejtësisë⁴ dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë parashikon nxitjen e arsimimit dhe trajnimit profesional të të miturit në mjediset e institucionit ose jashtë tij. Në këtë rast, institucioni bashkëpunon me institucionin arsimor që do të ketë klasat e mësimin në institucion ose me strukturat e formimit profesional.

Në rast se i mituri ka vijuar me arsimin dhe ka marrë pjesë në programet e formimit profesional gatë qëndrimit në institucion, kjo e ndihmon të miturin për të vijuar arsimimin dhe për të gjetur punë pas lirim.

e) Gjetja e punësimit

Ligji nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” zbatohet edhe për të mitur dhe të rinj në konflikt me ligjin. I mituri asistohet nga programet e shërbimeve të punësimit (shërbimet e informimit për punëkërkesit, punëdhënësit dhe për çdo person të interesuar; ndërmjetësimi për punësim; këshillimi dhe orientimi për karrierë, punësim e profesion) aponga programet e nxitjes së punësimit dhe programet e formimit profesional.

Këshillimi dhe orientimi për karrierë, punësim e profesion ofrohet nga struktura rajonale/vendore e punësimit nëpërmjet shërbimeve këshilluese të posaçme për fëmijët duke mbajtur parasysh edhe mundësitë e fëmijës për punësim dhe rregullat e Kodit të Punës në lidhje me punët e lejuara për të miturit. Një mundësi e mirë për fëmijët janë programet e formimit profesional dhe ndërmjetësimi për të gjetur punë për të miturit që janë pa kujdesje dhe familje.

⁴ Urdhër i përbashkët i Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë nr. 3348/1, datë 18/04/2018 “Për rregullimin e procesit arsimor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur”.

ë) Referimi te shërbimet e duhura sociale e shëndetësore

I mituri mund të ketë nevojë për shërbime shëndetësore ose psikologjike bazuar në nevojat e tij, si për shembull: në rast se aimund të jetë në varësi të drogës, ka çregullime të shëndetit mendor, apo ka nevojë të asistohet nga një psikolog. Në këto raste e të tjera, NJMF bashkëpunon me shërbimet që janë në nivel vendor.

f) Sigurimi i ndihmës dhe mbështetjes ekonomike

I mituri që nuk ka familje ose familja e tij është e papërshtatshme për të miturin, ai asistohet që të sistemohet dhe të ndihmohet me një ndihmë ekonomike.

8.2 Programet e edukimit dhe të rehabilitimit për të miturit e grupeve të veçanta

Të miturit në konflikt me ligjin mund të jenë edhe shtetas të huaj, persona me aftësi të kufizuara ose që i përkasim një pakice kombëtare. Ata përfitojnë nga të gjitha rregullat dhe programet që parashikon legjislacioni për të miturit pa diskriminim.

Për të miturit me shtetësi të huaj, programet e edukimit dhe rehabilitimit synojnë përgatitjen e tyre për riintegrim në vendet e origjinës. Drejtuesi i institucionit ku është i vendosur fëmija merr masa që në bashkëpunim me institucionet kompetente të garantojnë mbështetjen e nevojshme të të miturit deri në mbërritjen në vendin e tij të origjinës.

Sikurse të miturit që kanë të drejtë të vizitojnë familjen e tyre, i mituri i huaj lejohet të kryejë vizita të veçanta dhe të komunikojë me përfaqësuesit diplomatikë ose konsullorë të shtetit të tij, për të shmangur izolimin e tij social. Në rast se në Shqipëri nuk ka përfaqësim diplomatik ose konsullor, i mituri lehtësohet të vendosë kontakte për të komunikuar me përfaqësuesin diplomatik të shtetit që merr përsipër interesat e tij ose autoritetin kombëtar apo ndërkombëtar, që ka mision për t'u shërbyer interesave të këtyre personave. Ndër këta aktorë përmenden, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Komisioneri për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës pranë Avokatit të Popullit, zyra e emigracionit, OJF ose organizata që punojë me fëmijët, Organizata Ndërkombëtare e Imigracionit (IOM), Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), etj. Drejtuesi i institucionit bashkëpunon me drejtuesit e tjerë të institucioneve në nivel vendor me përfaqësuesit diplomatikë ose konsullorë, që përfaqësojnë të miturin, me qëllim plotësimin e nevojave të veçanta të tij.

Të miturit që janë pjesë e pakicave kombëtarepërfitojnë nga të gjithë programet e përcaktuara në KDPM dhe në ligjin “Për brojtjen dhe të drejtat e fëmijës”, por programet e edukimit dhe rehabilitimit ofrohen në gjuhën e tyre dhe të miturve që nuk zotërojnë mirë gjuhën zyrtare u ofrohen kurse gjuhe.

Për të miturit me aftësi të kufizuara sigurohen programe edukimi dhe rehabilitimi në përputhje me nevojat e tyre të veçanta, si dhe merren masa për t’u vendosur në institucione të specializuara, ku këto nevoja mund të përmbushen.

8.3 Detyrat e njësive për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës pas lirimit të fëmijës

Përgjegjësitë e NJMF për mbështetjen e fëmijës pas lirimit për arsye të kryerjes së dënimit ose lirimit me kusht përcaktohen në KDPM (neni 134).

NJMF bashkëpunon me disa institucione dhe struktura në një periudhë deri para 3 muajve nga moment i lindjes së të drejtës së lirimit me kusht. Institucionet janë:

- Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur apo qendra në të cilën është vendosur i mituri;
- Shërbimi i Provës;
- Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve;
- Organet e tjera të qeverisjes vendore (drejtoria e shërbimeve që mbulon strehimin, formimin profesional, arsimimin, programet shëndetësore sipas nevojave të të miturit, shërbimet e këshillit, ndërmjetësimit dhe punësimit të të miturit);
- Familja e të miturit, familja kujdestare, nëse ka, institucioni ku fëmija është vendosur.

Fillimisht, identifikohet njësia administrative ku i mituri banon ose ka planifikuar të banojë pas lirimit nga institucioni. Sikurse në rastin e lirimit për shkak se dënimi është kryer edhe në rastin e lirimit me kusht i mituri përfiton nga disa programe mbështetëse.

I mituri duhet të mbështetet për të pasur të paktën: *veshje të përshtatshme; mbështetje psikologjike; shpenzimet e udhëtimit për në banesë; mundësinë e ndjekjes së kurseve të formimit profesional, përveç rasteve kur ai mbështetet nga familja.*

Zbatimi i planit të integritetit dhe të mbikëqyrjes së shërbimeve ndaj të miturit koordinohet nga NJMF për një periudhë të paktën deri në 6 muaj pas lirimit të të miturit. Për të garantuar zbatimin e planit, NJMF koordinon punën dhe ndërveprimin ndërmjet të gjitha institucioneve që marrin pjesë në të.

9. Mbikëqyrja pas kryerjes së dënimit dhe dënimit me kusht

KDPM parashikon mbikëqyrjen e të miturit pas lirimit për arsye të kryerjes së dënimit ose të lirimit me kusht. Sipas rastit, i mituri rivendoset pranë prindit ose kujdestarit të tij dhe i garantohet mbrojtja sipas legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

QKMR në bashkëpunim me NJMF koordinon dhe zbaton planin e rehabilitimit dhe të rishoqërizimit për të paktën gjashtë muaj nga kryerja e dënimit ose e lirimit me kusht dhe mbikëqyr ecurinë e zbatimit të planit për rishoqërizimin e të miturit.

Sipas ligjit “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, i mituri në konflikt me ligjin konsiderohet “fëmijë në nevojë për mbrojtje”. Ai përfiton nga shërbimet, programet dhe masat mbrojtëse të parashikuara nga ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Sa i përket mbrojtjes së tij, KDPM i referohet ligjit nr. 18/2017, i cili parashikon disa masa mbrojtëse që mund të merren ndaj fëmijës në nevojë mbrojtje si: vendosja në përkujdesje alternative apo vendosja për mbikëqyrje të specializuar të fëmijës në mjedisin familjar. Këto masa vendosen ndaj të miturit të dënuar për një vepër penale, i cili është në gjendje të lirë dhe ka nevojë për mbrojtje. Kujdesi për të miturin në konflikt me ligjin pas kryerjes së dënimit ose lirimit duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe kujdesi i mëtejshëm nënkupton sigurimin mbështetës financiar.

Për këtë qëllim, punonjësi i NJMF harton Planin Individual të Mbrojtjes në bashkëpunim me QPKMR dhe Grupin Teknik Ndërsektorial, që funksionon në nivel bashkie ose pranë njësisë administrative të bashkisë. Të gjitha ndërhyrjet dhe shërbimet e parashikuara në Planin Individual të Mbrojtjes ofrohen falas.

Gjatë qëndrimit në institucion i mituri mund të ketë shfaqur aftësi dhe prirje në një fushë të caktuar. Pjesë e programeve të riintegritit janë edhe zhvillimi i aftësive të fëmijëve të tillë që ndihmojnë të miturin në konflikt me ligjin të rihyjë në komunitet në mënyrë të shëndetshme dhe të respektueshme menjëherë pas lirimit të tyre. Në raste të nevojshme një rol të veçantë luan shkolla, oficeri i sigurisë, organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në terren, por dhe komuniteti me të cilin mund të nënshkruhen marrëveshje bashkëpunimi për të siguruar që të miturit nuk do të qasen sërish me rrugën e krimit.

Pranimi në shkollë ose nga komuniteti i të miturit pas lirimit është një sfidë që ka nevojë të adresohet. Një ndihmesë në këtë proces japinveprimtaritë informuese dhe ndërgjegjësuere të zhvilluara në shkollë dhe në komunitet me nxënësit dhe prindërit, organizimet e të rinjve, mësuesi kujdestar, etj.

10. Praktika të mira të trajtimit të të miturve në konflikt me ligjin

Ndonëse KDPM ka pak vite që po zbatohet, ka disa praktika të mira të trajtimit të të miturve në konflikt me ligjin pas kryerjes së dënimit.

I mituri O. M., me ditëlindje 2004, banues në D., është dënuar për veprën penale “Vjedhje e kryer në bashkëpunim” e parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal. Pas përfundimit të dënimit, i mituri është kthyer në familjen e tij. Nga raportimet e NJMF D., i mituri nuk ka paraqitur më probleme në shkollë dhe në komunitet, ai vazhdon shkollën e mesme të përgjithshme klasën e 12. Familja është ndihmuar në mënyrë të vazhdueshme me pako ushqimore nga Bashkia D. Në takimin e zhvilluar me nënën e të miturit, punonjës in e NJMF dhe të QPKMR, nëna e tij u shpreh se i mituri është shumë mirë, është i rregullt në shkollë, maturant këtë vit dhe dëshiron të vazhdojë studimet për infermier.

I mituri J. Q., i ditëlindjes 2004, banues në qytetin e K., është dënuar për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje” e parashikuar nga neni 88/2 dhe 25 i Kodit Penal. Fillimisht, i mituri ka qenë në arrest shtëpie dhe, më pas, masa e sigurimit ndryshoi duke caktuar masën “detyrim për paraqitje”. Pas përfundimit të dënimit në Institutin e të Miturve Kavajë, i mituri përfundoi gjimnazin dhe pritët të vazhdoj arsimin e lartë. Ndërkohë, në kuadër të marrëveshjes të QPKMR me Caritas Shqipëri, janë bërë disa takime me të miturin dhe familjen e tij. Gjatë takimeve është diskutuar mbi nevojat e të miturit. Ai u shpreh se i pëlqente të gatonte dhe dëshironte të vazhdonte arsimin e lartë profesional për kulinari në T. QPKMR dhe Caritasi Shqiptar bënë të mundur që i mituri të regjistrohej në një kurs profesional 6-mujor për kulinari.

I mituri M.M., i ditëlindjes 2007, banues në qytetin e D., është dënuar për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje” e parashikuar nga neni 88/2 dhe 25 i Kodit Penal. Familja përbëhet nga 6 anëtarë, prindërit dhe 4 fëmijët, babai i fëmijëve aktualisht ndodhet në institucionin e vuajtjes së dënimit, dy motrat jetojnë jashtë shtetit me familjet e tyre, ndërsa vëllai i madh është në marrëdhënie pune. Kushtet social ekonomike të familjes janë të vështira dhe e vetmja e ardhur janë paratë e fituara nga djali i madh ose ndihma ekonomike që vajzat dërgojnë pranë familjes. I mituri nuk ka frekuentuar arsimin e detyrueshëm dhe në këto rrethana nuk di të shkruajë dhe të lexojë. PMF D. u shpreh se familjes i janë ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme por nuk janë pranuar.

Në takimin që QPKMR dhe Caritas zhvilloi me të miturin dhe nënën e tij, ata nuk pranuan shërbime dhe u shprehën se mund ti sigurojnë vet. QPKMR bëri disa përpjekje për të siguruar mundësinë që i mituri të fillojë arsimin fillor. I mituri kërkoi të fillojë një kurs profesional. Pas mbarimit të kursit, filloi punë me kohë të pjesshme në një firmë private si gdhendës mermeri.

I mituri E. Q., i ditëlindjes 2003, banues në bashkinë E. është dënuar për veprën penale “Prodhim dhe shitje të lëndës narkotike” të parashikuar nga neni 283/2 të Kodit Penal. Nga takimet me punonjës in e NJMF rezultoi se ai frekuenton shkollën e mesme të përgjithshme, frekuenton rregullisht aktivitetet sportive, pranë ekipit të futbollit të të rinjve dhe ka filluar punë pranë biznesit familjar (restorant).

11. Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në rolin e përfaqësuesit procedural

Sipas KDPM, NJMF-ja mund të luajë rolin e përfaqësuesit procedural për fëmijën në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar në procesin penal. Udhëzimi i përbashkët nr. 650, datë 13.09.2019 i Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e përfaqësuesve procedural për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në proceset penal” përcakton procedurën e përzgjedhjes së përfaqësuesve procedurale dhe rastet kur NJMF luan rolin e përfaqësuesit procedural.

NJMF-së, në kuadër të zbatimit të këtij Udhëzimi, i delegohen disa detyra:

- hartimi dhe përshtatja e listës me përfaqësuesit procedural për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në proceset penale një herë në vit;
- dërgimi i listës me përfaqësuesit proceduralë të miratuar pranë strukturave
- vendore të Policisë së Shtetit, Prokurorisë, gjykatave të rretheve gjyqësore dhe gjykatës së Apelit;
- zhvillimi trajnimeve për personat që ushtrojnë funksionet e përfaqësuesit procedural, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
- kryerja e rolit të përfaqësuesit procedural vetëm në rastet kur nuk ka persona të përzgjedhur.

Përfaqësuesi procedural caktohet nga lista e NJMF ku i mituri ka vendbanimin ose vendqëndrimin. Kjo do të thotë që një listë e tillë duhet të hartohet dhe përditësohet në nivel bashkie.

Sipas rastit, punonjësi i Policisë, Prokurori ose Gjykata njofton menjëherë NJMF-në në rastet kur përfaqësuesi ligjor i të miturit nuk mund të gjendet; ka abuzuar me të miturin, në rastin e një krimi në familje; ka dyshime lidhur me paanshmërinë e tij për sa i përket natyrës së marrëdhënieve të tij me pjesëtarin e familjes, i cili është dëmtuar ose ekziston një nga llojet e konfliktit të interesit. NJMF-të i përcjellin policive, Prokurorive dhe Gjykatave një listë të përditësuar të personave që do të kryejnë përfaqësimin procedural dhe ata caktojnë një person nga lista e dërguar nga NJMF që do të kryejë përfaqësimin procedural të të miturit, nëse:

- është e pamundur që brenda 1 (një) ore nga sjellja e të miturit në mjediset e organit procedues të gjendet përfaqësuesi ligjor;
- i mituri nuk jeton me përfaqësuesin e tij ligjor dhe/ose refuzon ta kontaktojë atë;
- përfaqësuesi ligjor vepron në kundërshtim me interesat e të miturit;
- i mituri është viktimë ose dëshmitar i një vepre penale të kryer nga përfaqësuesi i tij ligjor;
- përfaqësuesi ligjor akuzohet për të njëjtën vepër penale që akuzohet i mituri;
- përfaqësuesi ligjor nuk është i disponueshëm.

Në çdo rast, caktimi i përfaqësuesit procedural bëhet duke marrë parasysh mendimin e të miturit. Roli i përfaqësuesit procedural është i rëndësishëm pasi ushtron të gjitha përgjegjësitë që ka përfaqësuesi ligjor në procedimet penale dhe ai duhet të udhëhiqet gjithnjë nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës në vendimmarrjen e tij.

12. Mbrojtja e të dhënave personale të fëmijëve në kontakt dhe në konflikt me ligjin

Jeta private dhe të dhënat personale të të miturit në konflikt me ligjin respektohen plotësisht në çdo fazë të drejtësisë penale për të mitur, duke përfshirë periudhën gjatë qëndrimit në institucion/ qendër dhe atë pas lirimit dhe mbikëqyrjes së tij. Institucionet dhe strukturat e tjera që punojnë me dhëpër të miturit në konflikt me ligjin shkëmbejnë të dhëna personale për të miturin dhe familjen e tij, por KDPM ndalon që identiteti i të miturit dhe familjes së tij t'i komunikohet personave të pautorizuar dhe të bëhet publik në media, rrjete sociale, etj. Pas lirimit të të miturit, fashikulli personal i krijuar për të të ruhet dhe asgjësohet sipas rregullave që përcaktohen në legjislacionin në fuqi për arkivat.

13. Trajnimi dhe specializimi i punonjësve të NjMF

Rëndësia

Një nga risitë e KDPM është që të gjithë personat që punojnë me të miturin duhet të plotësojnë disa kritere në lidhje me përzgjedhjen, rekrutimin dhe vijimin e punës së tyre me të miturit. Çdo organ, duke përfshirë këtu dhe NJMF, ka detyrimin që të marrë masat për të siguruar që personat, të cilët punojnë me të miturit, të kenë njohuritë e nevojshme, ndërgjegjësimin profesional më të lartë për mbrojtjen e të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitarë, si dhe të marrin të gjitha masat e duhura për qëndrueshmërinë e tyre në këto pozicione pune. KDPM parashikon disa kushte dhe kritere të tjera në lidhje me punonjësit që punojnë me fëmijët ose në strukturat e mbrojtjes së fëmijëve.

Kërkesat ligjore sipas KDPM

KDPM përcakton standarde dhe kritere për personelin që punon me të miturit. Ligji ndalon që të punojë dhe të ofrojë shërbim ndaj të miturit çdo person i cili ka qenë i dënuar me një vendim të formës së prerë për një vepër penale të kryer me dashje ndaj të miturit, ose vepra ndaj dhunës në familje. Ky detyrim qëndron për të gjitha institucionet publike dhe private dhe organizatat jofitimruese (OJF-të) që ofrojnë shërbime për të miturit. Ato kanë detyrimin të sigurojnë që personat që janë dënuar për vepra penale ndaj të miturve të mos kenë asnjë kontakt me të miturin. Në rast se ky rregull nuk respektohet, personi mban përgjegjësi penale.

Gjithashtu, *Vendimi nr 186, datë 04.04.2019 "Për kriteret për punësimin e punonjësve të strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe të punonjësve që punojnë me fëmijët"* parashikon punonjësit e strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe punonjësit që punojnë me fëmijët. Në kuptim të këtij vendimi, punonjësit që punojnë me fëmijët janë ata punonjës, të cilët punojnë në institucione dhe struktura të tjera publike ose private, puna e të cilëve, e paguar ose vullnetare, përfshin kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët. Kontakti i drejtpërdrejtë mund të jetë fizik (si për shembull ndarja e hapësirave të përbashkëta me fëmijët) ose thjesht nëpërmjet komunikimit verbal (i shkruar ose elektronik). Këta punonjës duhet të respektojnë kriteret e përcaktuara nga KDPM.

Akreditimi i strukturave

Strukturat e mbrojtjes së fëmijës duhet të jenë të akredituara, duke kontrolluar kështu cilësinë e shërbimeve . Ngritja e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijës në mënyrë sistematike është e nevojshme dhe e detyrueshme.

Punonjës të trajnuar dhe specializuar në drejtësinë për të mitur

Krahas kriterëve të integritetit të çdo punonjësi, rekrutimi i tyre është një element i domosdoshëm dhe me rëndësi. Ligji për të drejtat e fëmijëve kërkon që punonjësit e NJMF të kenë formim në shkencat sociale. Vendimi nr. 186, datë 04.04.2019 “Për kriteret për punësimin e punonjësve të strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe të punonjësve që punojnë me fëmijët” shprehet se punonjësit duhet të kenë trajnimin dhe çertifikimin në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës duhet të ketë formim universitar si punonjës social; të ketë formim pasuniversitar ose përvojë pune në profesionin përkatës, jo më pak se dy vjet. Krahas njohurive të fushës, KDPM kërkon trajnimin e personelit që punon me fëmijët në lidhje me të drejtat e fëmijës në konflikt me ligjin, me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe duke përcaktuar fushat përkatësetë trajnimit të profesionistëve që punojnë me fëmijët në konflikt me ligjin ose viktimë/dëshmitarë.

Lista e fushave të trajnimit nuk është shteruese dhe ajo zgjerohet në varësi të detyrave dhe përgjegjësi që ka çdo profesionist, por drejtimet bazë të trajnimit përcaktohen në ligj, si për shembull:

- metodologjia e komunikimit me miturin në konflikt me ligjin;
- standardet dhe parimet që garantojnë të drejtat e të miturit;
- parimet dhe detyrimet etike që lidhen me funksionet e tyre;
- shenjat dhe simptomat që tregojnë se është kryer një vepër penale ndaj të miturit;
- aftësi dhe teknikat lidhur me vlerësimin e situatave kritike, vlerësimin e riskut, referimin e rastit dhe garantimin e parimit të konfidencialitetit;
- aftësi lidhur me teknikat e pyetjes së të miturve, psikologjinë e fëmijës dhe komunikimin me fëmijën në një gjuhë të përshtatshme për fëmijën;
- metodat e punës së detyrueshme për profesionistët që punojnë me të mitur; si dhe trajnimi i punonjësve të NJMF është i detyrueshëm dhe vazhdues. Punonjësi I
- NJMF, përfaqësuesi procedural, duhet të jetë i specializuar në drejtësinë për të mitur.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka dy detyrime që burojnë nga KDPM në lidhje me specializimin e punonjësve të NJMF: së pari, të hartojë programet e trajnimit në lidhje me drejtësinë penale për të mitur; dhe së dyti, të hartojë dhe përditësojë regjistrin e të trajnuarve lidhur me drejtësinë penale për të mitur.

Trajnimet e grupit shumëdisiplinor

Disa profesionistë përfshihen në trajtimin e të miturit në konflikt me ligjin. Prandaj, krahas njohjes së mirë të përgjegjësisë të çdo profesionisti në ekipin që menaxhon një rast konkret, rëndësi ka bashkërendimi dhe veprim në harmoni mes tyre. Krahas specializimit dhe përditësimit të njohurive të nevojshme dhe ndërgjegjësimit profesional për mbrojtjen e të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin, trajnimet e grupit shumëdisiplinor janë të dobishme pasi përmirësojnë menaxhimin e rastit.

Burimet njerëzore dhe financiare

Shërbimet e integruara për të miturit në konflikt me ligjin janë pa pagesë. Kjo nuk do të thotë se shërbimet nuk kanë kosto. Shërbimet kanë nevojë për burime njerëzore dhe financiare të mjaftueshme. Pagesat e shërbimeve mbulohen nga buxheti i institucioneve dhe ekzekutohen nga institucionet përkatëse, pranë të cilave realizohet shërbimi.

Në një sërë studimesh dhe raportesh vlerësimi është vënë në pah mungesa e shtrirjes së shërbimeve dhe programeve të mbrojtjes për të miturit në konflikt me ligjin në tërësinë e territorit të Republikës së Shqipërisë për arsye të kapaciteteve njerëzore dhe financiare. Aktet ndërkombëtare inkurajojnë përdorimin e vullnetarëve⁵ për të kontribuar me punën e tyre dhe për të rritur përfshirjen e komunitetit në zbatimin e sanksioneve dhe masave, por jo në kryerjen e punëve të cilat duhet të kryhen nga staf profesional.

Monitorimi i pavarur

Kontrolli i brendshëm dhe monitorimi i rregullt e i pavarur është një detyrim tjetër për të garantuar përmbushjen e standardeve në trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin. Të gjitha institucionet, shërbimet dhe mjediset përgjegjëse për kujdesin, arsimin dhe mbrojtjen e fëmijëve duhet të jenë subjekt i monitorimit të rregullt e të pavarur.

ASHDMF është organi që kontrollon cilësinë e shërbimit të strukturave të mbrojtjes së fëmijës dhe koordinon e organizon trajnime të edukimit vazhdues për punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe profesionistëve të tjerë që punojnë me fëmijët në nevojë për mbrojtje. Ajo bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse për realizimin e procesit të mbrojtjes dhe marrjes së masave për menaxhimin e rasteve të fëmijës në situatë migrimi, në situatë ndërkufitare dhe në nevojë për mbrojtje jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të fëmijës së pashoqëruar.

⁵ CM/Rec(2017)3 Rekomandim i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare mbi Rregullat Europian për sanksionet dhe masat komunitare <https://rm.coe.int/1680700a5a>

Shtojca 1: Kuadri ligjor bazë

Ka shumë akte ndërkombëtare, ligje dhe akte nënligjore që trajtojnë standardet e trajtimit të të miturit në konflikt me ligjin në institucion, në përgatitje për lirim, pas lirimit dhe për mbikqyrjen e tij me qëllim riintegrimin në familje dhe në shoqëri. Më poshtë gjeni disa nga aktet kryesore vendase:

Ligji nr. 37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur”

Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

Kodi Penal, I ndryshuar

Kodi i Procedurës Penale, i ndryshuar

Ligji nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”

Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”

Ligji nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”

Ligji 139/2015 “Për organet e vetqeverisjes vendore”, i ndryshuar

Ligj nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”

Ligj nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”

Ligji nr. 38/2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës”

Akte nënligjore

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 314, datë 15.5.2019 “Për organizimin, funksionimin, si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e qendrës së parandalimit të krimeve të të miturve dhe të rinjve”, i ndryshuar

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.635, datë 25.09.2019 “Për rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”;

Udhëzimi Nr. 262. dt 26.05.2021 "Miratimin e metodologjisë së punës për menaxhimin e rastit të fëmijëve në konflikt me ligjin, nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës”;

Udhëzim i përbashkët Nr.650. dt 13.09.2019 "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e përfaqësuesve proceduriale për fëmijet në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal”;

Vendimi nr. 353, datë 12.6.2018 “Për rregullat e funksionimit të grupit teknik, ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe njësive administrative”

Vendim i Këshillit të Ministrave nr.148, datë 13.3.2018 “Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimorë e koordinues institucionalë, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës

Vendim i Këshillit të Ministrave. 186, datë 4.4.2019 “Për kriteret për punësimin e punonjësve të strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe të punonjësve që punojnë me fëmijët”.

Urdhër i përbashkët i Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë nr. 3348/1, datë 18/04/2018 “Për rregullimin e procesit arsimor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur”



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Tel: +355 (0)4 223 3671
Mobile AHC Office: 068 20 236 99
Mobile Legal Clinic: 069 40 757 32
Email: office@ahc.org.al
Postal Code: 1752

Albanian Helsinki Committee Brigada e VIII Street, "Tekno Projekt" Tower,
Shkalla 2, Apartamenti 10, Kati 6